EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5689
E mërkurë, 30 janar 2019
çmimi 0.40 €

Komisioni për Administratë Publike miraton Projektligjin për pagat

FAQE 9

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

FLET PËR "EPOKËN E RE", RAMUSH TAHIRI FAQE 4-5

Taksa mund të çojë në prishjen e koalicionit qeverisës

Politologu Ramush Tahiri ka vlerësuar se kohën e fundit taksa ka shpërfaqur përplasjen në mes të liderëve të koalicionit qeverisës. Ai ka thënë se pas deklarimit të Kadri Veselit për pezullimin e taksës për 120 ditë dhe deklarimit të Ramush Haradinajt se taksa mbetet në fuqi nuk mund të vazhdohet më tutje, por njëra palë duhet të heqë dorë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka deklaruar se taksa mund të çojë në prishjen e koalicionit dhe rrëzimin e Qeverisë. Sipas tij, taksa nuk e ka arritur efektin e duhur, por nëpërmjet saj Kosova është ndërkombëtarizuar për të keq. Tahiri ka thënë se taksa duhet të hiqet meqë këtë po e kërkon ShBA-ja

Haradinaj: Taksa nuk hiqet pa u plotësuar kushtet

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se pa u plotësuar kushtet e kërkuara nga ai nuk do të hiqet taksa për mallrat serbe dhe boshnjake. Ai ka deklaruar të martën se nuk e ka aspak problem nëse kjo taksë do t'i prishë raportet me ndërkombëtarët. Haradinaj ka shprehur siguri se kjo taksë do të mbetet në fuqi deri në muajin qershor, edhe nëse vendi shkon në zgjedhje të parakohshme FAQE 3

Thaçi i shkruan presidentit Trump: Zotohem për marrëveshje me Serbinë

FAQE 5

AKTUALE

DEFAKTORIZIMI I KOSOVËS SHQIPTARE, INTERES VETËM I SERBISË F. 11

Xhevat BISLIMI

UP-ja SHËNON NGRITJEN MË TË MADHE NË WEBOMETRICS, RENDITET E 1471-TA NË BOTË F. 7

KOSOVA SHËNON NGECJE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT F. 7

EKONOMI

LV-JA KUNDËR PRIVATIZIMIT TË TELEKOMIT F. 8

MATOSHI PRET NË TAKIM ZYRTARË TË BB-SË, FLASIN PËR PROJEKTET NË FUSHËN E AJRIT F. 8

KULTURË

GOLI OTOKU, KRIMI QË S'HARROHET KURRË F. 13

SPORT

DREJTUESIT E FC VUSHTRRIA: DEKLARATAT E TAHIRIT, TË PAVËRTETA F. 14

KATËR KLUBE TË KOSOVËS NË GARAT NDËRKOMBËTARE F. 14

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Gazeta amerikane: Ja pse po ngrihet baza e NATO-s në Shqipëri

UASHINGTON, 29 JANAR - Gazeta e Ushtrisë amerikane, "Stars and Stripes" i ka kushtuar një shkrim lajmit se NATO-ja ka nisur punën për ngritjen e një baze ajrore në Shqipëri.

Gazeta thekson se qëllimi i ngritjes së kësaj baze është kundërvënia ndaj influencës ruse në rajon.

"NATO-ja pritet të zgjerojë prezencën në Ballkan- ku Perëndimi dhe Rusia janë ngërthyer në një betejë për ndikim- ndërsa Shqipëria përgatitet për të pritur të parën bazë ushtarake të aleancës në rajon", shkruan gazeta.

Tutje thuhet se zyrtarët shqiptarë dhe amerikanë shënuan të enjten nisjen e fazës së parë të projektit prej 58 milionë euro për modernizimin e bazës ajrore të Kuçovës në qendër të Shqipërisë, në mënyrë që ajo të jetë në përputhje me standardet e NATO-s.

Në shkrim theksohet se Shqipëria nuk ka avionët e saj dhe se prej vitit 2009 kur u bë pjesë e Aleancës, hapësira ajrore është monitoruar nga Italia dhe Greqia.

Më tej theksohet se investimi erdhi pasi ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka bëri një vizitë në Pentagon ku kërkoi ngritjen e një baze të ShBA-së ose të NATO-s në rajon për t'iu kundërvënë ndikimit rus, por edhe interesave të vendeve si Kina dhe Irani.

"Rajoni ka qenë fushëbetejë për ndikim mes Perëndimit dhe Rusisë, e cila ka kritikuar lëvizjet për të zgjeruar anëtarësimin e NATO-s në këtë rajon, duke theksuar se kërcënon sigurinë rajonale", thekson shkrimi.

Limaj e Ahmeti takohen me zyrtarët e BE-së, nuk deklarohen për medie

Dy bashkëkryesuesit e Ekipit negociator për bisedimet me Serbinë, Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti, në takimin e zhvilluar në Bruksel me bashkëpunëtorët e shefes së diplomacisë evropiane, Federica Mogherini, kanë shqyrtuar përparimin e arritur deri më tani në normalizimin e raporteve në dialogun Kosovë-Serbisë. Limaj e Ahmeti nuk janë deklaruar për media

PRISHTINË, 29 JANAR - Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti, dy bashkëkryesuesit e Ekipit negociator për bisedimet me Serbinë, të martën kanë zhvilluar një takim në Bruksel me zyrtarët e Bashkimit Evropian nga kabineti i shefes së diplomacisë evropiane, Federica Mogherini.

Zyrtarë të Bashkimit Evropian i thanë korrespondentes së "Radios Evropa e Lirë" në Bruksel se BE-ja dhe bashkëkryesuesit e dialogut nga Prishtina kanë rishikuar përparimin e arritur deri më tani në normalizimin e raporteve në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Zyrtarët e BE-së thanë, po ashtu, se "bashkëkryesuesit nga Prishtina kanë ofruar të dhëna rreth zhvillimeve të fundit, përfshirë edhe Ligjin për dialogun dhe punën e komisionit që po punon në platformën për dialog".

"BE-ja, mirëpret përpjekjet e tyre për të çuar përpara mandatin e Kuvendit të Kosovës drejt një pozicioni më unifikues në koordinim të ngushtë me të gjitha trupat kushtetues", kanë thënë zyrtarë të Bashkimit Evropian.

Pas takimit në Bruksel, dy bashkëkryesuesit e Ekipit negociator nga Prishtina, Limaj e Ahmeti, nuk janë deklaruar për media.

Ky ishte takimi i dytë i Ekipit negociator nga Kosova me zyrtarët e BE-së.

Takimi i parë është zhvilluar po ashtu këtë muaj, kur është thënë se është diskutuar për fazën e ardhshme të dialogut Kosovë-Serbi, si dhe tarifën doganore 100%, të cilën Qeveria e Kosovës ua ka vënë prodhimeve të importuara nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina.

Mediet në Kosovë kanë raportuar se në Bruksel janë ftuar vetëm këta dy, por jo edhe për anëtarët e tjerë të ekipit. Po ashtu është raportuar se Bashkimi Evropian do të përpiqet që Limaj dhe Ahmetin t'i takojë me delegacionin nga Serbia.

Para nisjes për në Bruksel, bashkëkryesuesi Fatmir Limaj, ka thënë se në këtë takim nga pala kosovare do të marrin pjesë vetëm ai dhe bashkëkryesuesi Shpend Ahmeti. "Në takim do të jemi vetëm unë dhe Shpend Ahmeti. Do të takohemi me përfaqësues të zyrës së Frederica Mogherinit për të biseduar për modalitetet e vazhdimit të dialogut. Më tepër është një takim për të biseduar për modalitetet e mëtutjeshme si do të zhvillohet dialogu", ka thënë Limaj.

Video e arratisjes së Gruevskit në Shqipëri është fshirë

TIRANË, 29 JANAR - Shqipëria nuk i ka dorëzuar Maqedonisë regjistrimet nga kamerat e sigurisë mbi arratisjen e ish-kryeministrit maqedonas, Nikolla Gruevski me arsyetimin se janë fshirë.

Kjo u bë e ditur nga prokurori shtetëror i Maqedonisë, Lubomir Jolevski. Ai ka sqaruar para gazetarëve se regjistrimet nuk janë fshirë qëllimisht por se sistemi i mbikëqyrjes nga ana e Shqipërisë në mënyrë automatike i ka larguar nga sistemi regjistrimet e vjetra.

"Nuk janë fshirë qëllimisht nga shërbimet kufitare shqiptare. Ka disa momente në shpjegimin e tyre. Një gjë është se të dhënat janë të shumta në kamerat e sigurisë dhe se sistemi nuk mund t'i ruajë për një kohë të gjatë. Nuk i kanë fshirë, por ato pajisje punojnë në mënyrë automatike", ka deklaruar Jolevski.

Pas kësaj mbetet dilema se cilën rrugë saktë ka shfrytëzuar ish-kryeministri i cili ka ikur nga Maqedonia më 9 nëntor të vitit të kaluar. Prokuroria është duke hetuar disa regjistrime që ka siguruar nga Mali i Zi por se është duke grumbulluar edhe prova tjera.

Ish-kryeministri Gruevski ka fituar azil politik në Hungari, Kundër tij është lëshuar flet-arrest ndërkombëtar.

Gruevski është dënuar me dy vjet burgim për shpërdorim të detyrës zyrtare në rastin e blerjes së një makine zyrtare të blinduar në vlerë prej afro 600 mijë euro. Kundër tij janë duke u zhvilluar edhe të paktën katër procese tjera gjyqësore.

Në disa publikime në rrjetin social Facebook, pas arratisjes, Gruevski ka thënë se akuzuar pushtetin për ndjekje politike.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Haradinaj: Taksa nuk hiqet pa u plotësuar kushtet

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se pa u plotësuar kushtet e kërkuara nga ai nuk do të hiqet taksa për mallrat serbe dhe boshnjake. Ai ka deklaruar të martën se nuk e ka aspak problem nëse kjo taksë do t'i prishë raportet me ndërkombëtarët. Haradinaj ka shprehur siguri se kjo taksë do të mbetet në fuqi deri në muajin qershor, edhe nëse vendi shkon në zgjedhje të parakohshme

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 29 JANAR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, edhe një herë ka qartësuar se Qeveria e Kosovës nuk tërhiqet nga taksa 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës. Në një konferencë për medie, pas mbledhje së Qeverisë, ai ka bërë me dije se Kosova nuk lëviz nga ky pozicion derisa të plotësohen kushtet apo kriteret që ka kërkuar në letrën dërguar qeverive të vendeve më të fuqishme botërore për pezullimin apo shfuqizimin e taksës.

Haradinaj ka treguar se ka parë edhe më herët propozimin e kryeparlamentarit Kadri Veseli që taksa të pezullohet për 120 ditë, në mënyrë që t'i jepet shansi vazhdimit të dialogut. "E kam parë një dokument të kryetarit Veseli, me propozime të caktuara. Ajo që u kam shkruar vendeve të Quintit është vendimi zyrtar i Qeverisë", ka thënë Haradinaj.

Madje ai ka deklaruar se, edhe nëse bie Qeveria, taksa mbetet në fuqi deri në muajin qershor. "Sa i përket prishjes së koalicionit dhe shkuarjes në zgjedhje potenciale, i bie që taksa mbetet deri në qershor, gjithqysh. Sepse, nëse shpallen zgjedhjet, duhen 45 ditë derisa të mbahen, derisa të krijohet parlamenti janë edhe 30 ditë të tjera, pastaj edhe formimi i Qeverisë merr disa ditë. Kështu që, hyjmë në verë. Pra, bëhuni gati se hyjmë në verë me taksë", është shprehur ai.

Kryeministri ka qartësuar se nuk e ka aspak problem nëse kushtet e vendosura për heqjen e taksës do të ndikonin në prishjen e raporteve me ndërkombëtarët. Sipas tij, kush është kundër atyre kushteve është kundër Kosovës. "Nëse një prej kushteve që kam vënë unë mund të m'i prish raportet me dikë, nuk ka dert. Dua të mbroj të drejtën time. Nëse dikush ka problem me ato kërkesa që ne i kemi vendosur, atëherë jemi të prishtë apriori. Viti 2022 po vjen, kohë kur Serbia ka për të hyrë në BE. Nuk e kuptoj pse ne duhet të japim nga vetja në këto rrethana", është shprehur Haradinaj.

Madje kryeministri ka deklaruar se nuk e ka problem të prishet edhe me ShBA-në për kushtet e vendosura për taksën. "Kushdo që ka problem, qoftë i brendshëm apo i jashtëm me këto kërkesa, atëherë del kundër të drejtës dhe kushtetutës sonë. Ne nuk kemi mirëkuptim me dikë që ka probleme me këto kritere. Atëherë i bie tërheqje e njohjes. Nuk besoj se ShBA-ja ka probleme me këto kushte por, kushdo që ka, atëherë dihet në çfarë marrëdhëniesh jemi", ka thënë Haradinaj.

I pari i Qeverisë ka ftuar gjithë spektrin politik që ta fuqizojë taksën në raport me Serbinë ngaqë, sipas tij, kjo do ta shpëtojë ndarjen e Kosovës. "Dëshira ime është të jemi unikë të gjithë. Nëse e zbehim pozicionin tonë politik të taksës, atëherë nuk kemi alternativë pos territorit dhe Republika Serpska për t'i dhënë Serbisë. Këtë duhet ta kuptojë edhe LDK-ja e cila po tregohet si e mençur", është shprehur Haradinaj, duke i ftuar të gjithë deputetët e Kosovës që të mos e përkrahin heqjen e taksës.

Qeveria ndan 15 mijë euro për familjen e Arian Dacit

Qeveria e Kosovës mbledhjen e së martës e ka nisur me një minutë heshtje në nderim të ish-zëvendësministrit të Diasporës, Arian Daci, i cili ka humbur jetën tragjikisht më 26 janar në Brezovicë. Po ashtu, vendimi i parë që ka marrë Qeveria në këtë mbledhje ka qenë ndarja e 15 mijë euro për familjen e ish-zëvendësministrit Arian Daci.

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2019 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në të cilin program do të përfshihen edhe këto Projektligje: Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2018 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian; Projektligji për Statusin e Forcave të Huaja në territorin e Republikës së Kosovës; dhe Projekt Kodi Civil. Po ashtu, kabineti qeveritar në këtë mbledhje ka miratuar Strategjinë për të drejtat e fëmijëve 2019-2023 dhe Planin e veprimit 2019-2021.

Austria rikonfirmon përkrahjen për liberalizimin e vizave

VJENË, 29 JANAR (ER) - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka takuar në Vjenë ministrin e BE-së, Artit, Kulturës dhe Medies së Austrisë, Gernot Blumel, me të cilin ka diskutuar për procesin integrues të Kosovës, në veçanti për rëndësinë e vendimit për liberalizimin e vizave nga BE-ja pas plotësimit të të gjitha kritereve. Hoxha ka theksuar se mbështetja e Austrisë është tejet e rëndësishme për Kosovën dhe institucionet e saj. "Ne kemi dëshmuar përkushtimin tonë se duam t'i zbatojmë reformat, MSA-në, fuqizimin e sundimit të ligjit dhe ngritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve tanë. Ne kemi nevojë për përkrahjen e procesit integrues si dhe integrimin në organizatat ndërkombëtare,, në veçanti kemi nevojë që BE-ja ta mbajë fjalën e dhënë e të mos mbajë të izoluar qytetarët tanë", ka thënë Hoxha, duke kërkuar sërish përkrahjen e Austrisë për procesin e vendimmarrjes për liberalizimin e vizave. Ndërsa ministri austriak Gernot Blumel ka vënë në dukje përkrahjen e Austrisë për procesin integrues. Ai e ka rikonfirmuar përkushtimin e Austrisë për liberalizimin e vizave për kosovarët, zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor, ku Kosova trajtohet e barabartë me vendet e tjera në rajon.

Flet për "Epokën e re", Ramush Tahiri

Taksa mund të çojë në prishj

Politologu Ramush Tahiri ka vlerësuar se kohën e fundit taksa ka shpërfaqur përplasjen në mes të liderëve të koalicionit qeverisës. Ai ka thënë se pas deklarimit të Kadri Veselit për pezullimin e taksës për 120 ditë dhe deklarimit të Ramush Haradinajt se taksa mbetet në fuqi nuk mund të vazhdohet më tutje, por njëra palë duhet të heqë dorë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka deklaruar se taksa mund të çojë në prishjen e koalicionit dhe rrëzimin e Qeverisë. Sipas tij, taksa nuk e ka arritur efektin e duhur, por nëpërmjet saj Kosova është ndërkombëtarizuar për të keq. Tahiri ka thënë se taksa duhet të hiqet meqë këtë po e kërkon ShBA-ja

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 29 JANAR - Njohësi i proceseve politike, Ramush Tahiri, ka thënë të martën se Qeveria Haradinaj nuk mund të shkojë tutje meqë nuk ka politikë unike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se taksa ka arritur të sjellë përplasje brenda koalicionit qeverisës. Madje, sipas Tahirit, taksa mund të çojë edhe në prishjen e koalicionit PAN dhe rrëzimin e Qeverisë. "Deri më tani partnerët e koalicionit kanë qenë unikë, madje edhe janë lëvduar për ta marrë primatin për vendosjen e taksës. Por, tash së fundi, taksa ka filluar t'i përplasë partnerët e koalicionit. Duket se nuk ka harmonizim në mes të partnerëve të koalicionit meqë ka deklarime të kundërta. Në mënyrën siç po shkojnë proceset, mund të ndodhë që Qeveria të dorëhiqet dhe vendi të shkojë në zgjedhje. Po ashtu, mund të bjerë Qeveria dhe të mos hiqet taksa, apo edhe të hiqet taksa dhe të bjerë edhe Qeveria. Qeveria mund të rrëzohet me dorëheqje të kryeministrit, me largimin e PDK-së, ose Kuvendi ta shkarkojë Qeverinë apo edhe Kuvendi me 2/3 ta shpërndajë vetveten dhe ta çojë vendin në zgjedhje", ka deklaruar Tahiri. Ai ka thënë se taksa nuk e ka arritur efektin e duhur, por përmes saj Kosova vetëm është ndërkombëtarizuar për të keq. Tahiri ka vlerësuar se taksa duhet të hiqet meqë këtë po e kërkon ShBA-ja dhe, sipas tij, nuk duhet të vihet në pikëpyetje politika e ShBA-së që është garantuese e pavarësisë së Kosovës. "Nuk është masë e cila mund të përkrahet. Sipas mendimit tim, taksa duhet të hiqet sepse po kërkon ShBA-ja. Nuk duhet të vihet në pikëpyetje politika e ShBA-së sepse garantuese e pavarësisë së Kosovës është ShBA-ja. Krejt kjo që është arritur është falë mbështetjes amerikane. Duhet të respektohen miqtë dhe nuk duhet të vihet në verifikim politika e tyre sepse Amerika është superfuqi që bën politikën ku inkuadrohet Kosova, por Kosova nuk mund t'ia imponojë politikën ShBA-së", është shprehur Tahiri.

"Epoka e re": *Z. Tahiri, duke pasur parasysh deklarimet e fundit të kryeparlamentarit Veseli dhe të kryeministrit Haradinaj, a mendoni se për shkak të taksës ka filluar përplasja e koalicionit qeverisës?*

Tahiri: Deri më tani partnerët e koalicionit kanë qenë unikë, madje edhe janë lëvduar për ta marrë primatin për vendosjen e taksës. Por, tash së fundi, taksa ka filluar t'i përplasë partnerët e koalicionit. Duket se nuk ka harmonizim në mes të partnerëve të koalicionit meqë ka deklarime të kundërta. Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj thotë se taksa jo vetëm se nuk do të hiqet, por Qeveria është kreative dhe do të marrë masa shtesë. Ndërkohë kryeparlamentari Kadri Veseli propozoi që të ketë pezullim të taksës prej 120 ditëve në mënyrë që t'i jepet shansi dialogut dhe harmonizimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimin Evropian (BE) të cilët po kërkojnë që taksa të hiqet pa asnjë kusht apo parakusht. Në anën tjetër, kryeministri Ramush Haradinaj u ka dërguar letër ambasadorëve të vendeve të Quintit duke paralajmëruar disa kushte, me plotësimin e të cilave mund të hiqet taksa. Tani kemi tri nivele: Hoxhaj që paralajmëroi masa të tjera ndaj Serbisë, Veseli që kërkon pezullimin e taksës për 120 ditë dhe Haradinaj i cili u ka dërguar letër kryeministrave më të rëndësishëm të botës nga të cilët ka kërkuar përkrahje për taksën. Kryeministri, po ashtu, kërkon të ketë edhe një konferencë ndërkombëtare për arritjen e marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e cila do ta garantonte zbatimin e kësaj marrëveshje. Gjithashtu, e kemi edhe qëndrimin e presidentit i cili po kërkon, siç po shprehet figurativisht, që 'bora të shkrihet' dhe që pa asnjë kusht të hiqet taksa, meqë e konsideron se është kundër interesave të Kosovës dhe Amerikës.

"Epoka e re": *Këto përplasje për taksën a mund të çojnë në prishjen e koalicionit apo rrëzimit të Qeverisë?*

Tahiri: Që nga fillimi ka qenë një koalicion me zor, meqë e dini si është formuar. Madje dihet si funksionon koalicioni, ku secili lider shkarkon dhe emëron ministrat për qejfe të veta dhe kryeministri Haradinaj vetëm i

en e koalicionit qeverisës

nënshkruan këto ndryshime. Një gjë e tillë nuk është normale në shtetet demokratike dhe nuk është në rregull që meritokracia e partive politike ta udhëheqë ekzekutivin, sepse ky i fundit miraton buxhetin dhe politikat programore e zhvillimore. Tash pas më shumë së një viti të qeverisjes, si duket PDK-ja po mendon për zgjedhjet e ardhshme dhe po i duket që AAK-ja dhe Ramush Haradinaj po forcohen shumë, prandaj PDK-ja po dëshiron të distancohet. Pas deklarimit të Veselit për pezullimin e taksës për 120 ditë dhe deklarimit të Haradinajt, se taksa mbetet në fuqi, nuk mund të vazhdohet më tutje, por njëra palë do të heqë dorë. Qeveria nuk mund të vazhdojë tutje sepse nuk ka politikë unike. Tashmë janë shtuar edhe grevat të cilat dyshohen se janë të nxitura, por Qeveria nuk po mund t'i menaxhojë.

"Epoka e re": *Sipas mendimit tuaj, më përpara do të hiqet taksa apo do të bjerë Qeveria?*
Tahiri: Kështu siç po shkojnë proceset, mund të ndodhë që Qeveria të dorëhiqet dhe vendi të shkojë në zgjedhje. Po ashtu, mund të bjerë Qeveria dhe të mos hiqet taksa, apo edhe të hiqet taksa dhe të bjerë edhe Qeveria. Qeveria mund të rrëzohet me dorëheqje të kryeministrit, me largimin e PDK-së, ose Kuvendi ta shkarkojë Qeverinë apo edhe Kuvendi me 2/3 ta shpërndajë vetveten dhe ta çojë vendin në zgjedhje. Mirëpo zgjedhjet në Kosovë i detyrojnë edhe zgjedhjet në Serbi dhe anasjelltas. Prandaj, kjo periudhë mund të përcillet me zgjedhje në Ballkan dhe në institucionet e BE-së, me ç'rast dialogu mund të vazhdojë në nivel të presidentëve ose të mos vazhdojë deri në shtator.

"Epoka e re": *Kryeministri ka deklaruar se edhe nëse shkohet në zgjedhje, taksa do të mbetet deri në qershor.*
Tahiri: Taksa është problem sepse nuk ka kush ta heqë. Taksa duhet të hiqet nga ata që është vendosur. BE-ja dhe ShBA-ja po kërkojnë heqjen e taksës sepse taksa ka bllokuar Kosovën në dialog, në marrëdhëniet ndërkombëtare me BE-në, por edhe me shtetet individualisht sepse askush nuk po na fton në vizita dhe nuk po na viziton.

"Epoka e re": ShBA-ja duhet ta mirëkuptojë Kosovën për vendosjen e taksës meqë Serbia në vazhdimësi e pengon ecjen përpara të shtetit të Kosovës apo taksa duhet të hiqet pasi po kërkojnë amerikanët?
Tahiri: Taksa nuk guxon t'i hapë rrugë as Kosovës dhe as shteteve të tjera sepse nuk është formë normale e veprimit. Kurse Serbia nuk e ka ashpërsuar vetëm tash politikën, por gjithmonë politika e saj ka qenë kështu.

"Epoka e re": *Parashikoni heqjen e taksës apo shkuarjen në zgjedhje?*
Tahiri: Edhe po të hiqet taksa, ka filluar mosbesimi brenda koalicionit, përkatësisht në mes të PDK-së dhe AAK-së. Në këtë formë siç është, edhe me Listën Serbe, ky koalicion nuk e ka shumicën, prandaj do të ishte e moralshme të rrëzohet ose të tërhiqet. Do të ishte më e ndershme që PSD-ja të bëhet pjesë e koalicionit, të sigurohen numrat, të kalohet buxheti dhe të ketë një program zhvillimor. Taksa nuk është duke i bërë dëm të madh Serbisë. Në dyqanet tona nuk mungon asnjë produkt serb.

"Epoka e re": *Taksa nuk ka pasur efekt?*
Tahiri: Taksa nuk e ka arritur efektin e duhur. Kosova përmes kësaj takse është ndërkombëtarizuar për të keq meqë asnjë prej vendeve nuk e ka mbështetur vendosjen e saj. Nuk është masë e cila mund të përkrahet. Sipas mendimit tim, taksa duhet të hiqet sepse po kërkon ShBA-ja. Nuk duhet të vihet në pikëpyetje politika e ShBA-së sepse garantuese e pavarësisë së Kosovës është ShBA-ja dhe krejt kjo që është arritur, është falë mbështetjes amerikane. Duhet të respektohen miqtë dhe nuk duhet të vihet në verifikim politika e tyre sepse Amerika është superfuqi që bën politikën ku inkuadrohet Kosova, por Kosova nuk mund t'ia imponojë politikën ShBA-së.

"Epoka e re": *Kryeministri ka deklaruar se taksa do të mbetet edhe nëse prishemi me amerikanët. Mund të prishet miqësia dhe partneriteti me ShBA-në?*
Tahiri: Politika nuk bëhet kështu. Po të ishte Kosova superfuqi e Ballkanit Perëndimor, po i prishka marrëdhëniet me krejt shtetet. Nuk është politikë e mençur vendosja e taksës. Taksa nuk e gjunjëzon Serbinë sepse në prodhim bruto dhe eksport të saj nuk e kalon as gjashtëpërqindëshin. Pra, kurrgjë nuk i bën dëm. Serbia po bën propagandë kinse taksa e ka dëmtuar. Kosovës i mungon një marrëveshje dhe krijimi i një forumi të brendshëm në të cilin do të debatoheshin çështjet e rëndësishme për vendin.

Thaçi i shkruan presidentit Trump: Zotohem për marrëveshje me Serbinë

Prishtinë, 29 janar (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në fillim të këtij muaji ia ka kthyer letrën presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, në të cilën është zotuar se do të punojë për marrëveshjen historike me Serbinë. Në letrën të cilën e ka bërë publike presidenti Thaçi, zotohet se do ta kryejë pjesën e vet të punës dhe do të apelojë te qytetarët që ta ndjekin thirrjen e bërë nga presidenti Trump në letrën e dhjetorit, që "të flasin me një zë gjatë bisedimeve për paqe dhe të përmbahen nga veprimet që do të bënin një marrëveshje më vështirë të arritshme".
Presidenti Thaçi e ka siguruar presidentin Trump se është i gatshëm dhe i vullnetshëm t'i bëjë kompromiset e nevojshme për të arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe të balancuar, e cila do t'i përfshinte të gjitha çështjet e hapura dhe do t'i jepte fund konfliktit shekullor me Serbinë. "Marrëveshja e arritur nuk do të jetë paqe e përkohshme apo konflikt i ngrirë", i shkruan Thaçi presidentit Trump.
Thaçi ka thënë se Kosova është duke u munduar të dalë nga ky qark dhe të arrihet një marrëveshje përfundimtare në të cilën të dyja palët e njohin njëra-tjetrën dhe heqin dorë nga konflikti dhe, sipas së cilës, Kosova bëhet anëtare e Kombeve të Bashkuara.
Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, në dhjetor të vitit të kaluar me anë të një letre iu kishte drejtuar presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi. Presidenti Trump në këtë letër u bënte thirrje liderëve të Kosovës që "ta shfrytëzojnë këtë moment unik, të flasin me një zë të unifikuar gjatë bisedimeve për paqe dhe të përmbahen nga veprimet që do ta bënin të vështirë arritjen e një marrëveshjeje".
Në letër, po ashtu, thuhet se presidenti Trump do të jetë nikoqir i presidentëve të Kosovës dhe të Serbisë, Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiq, në Shtëpinë e Bardhë, për të festuar atë që do të jetë një "marrëveshje historike".

Kurti takon ambasadorin amerikan, flasin për dialogun

Prishtinë, 29 janar (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe nënkryetari Besnik Bislimi, kanë zhvilluar një takim në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë me ambasadorin Philip S. Kosnett. Sipas një komunikate të LV-së, në këtë takim është diskutuar për aktualitetin politik në vend. "Takimi kaloi në një frymë shumë konstruktive dhe u diskutua për çështje që aktualisht dominojnë interesat kombëtare të vendit. Ambasadori foli për rëndësinë që ka Kosova në politikën e jashtme të ShBA-së dhe për nevojën që pala e Kosovës paralelisht të kultivojë raporte shumë të mira edhe me Bashkimin Evropian, anëtarësimi në të cilën përbën aspiratën kryesore të Kosovës. Po ashtu, u shkëmbyen edhe qëndrimet e të dyja palëve për dialogun dhe tarifën doganore ndaj importeve nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, për dëmet që po i shkaktohen vendit nga nepotizmi dhe korrupsioni në sektorin publik dhe për domosdoshmërinë e reformimit të administratës publike në Kosovë", është thënë në komunikatën e Vetëvendosjes, në të cilën theksohet më tutje se kryetari Kurti e ka njoftuar ambasadorin amerikan për qëndrimet e Lëvizjes Vetëvendosje në raport me dialogun; për fazat që duhen përcjellë me synim ndërtimin e një platforme dhe ekipi negociator që do të garantonte një përfaqësim serioz në dialog; për arsyet se pse Qeveria nuk duhet të heqë dorë nga tarifa doganore, por edhe për vizionin e Vetëvendosjes rreth vendosjes së sundimit të ligjit e luftimit të korrupsionit, prioritizimin e gjenerimit të punësimit si synim kyç makroekonomik si dhe reformimin e sistemit arsimor dhe atij shëndetësor si burim me rëndësi për mbështetjen e rritjes ekonomike të Kosovës.

PDK-ja vazhdon bashkëpunimin me Institutin Nacional Demokratik

"Gjykuar sipas rezultateve dhe informatave që kemi nga kuvendet e nëndegëve, pozicioni i gruas, pas përfundimit të procesit zgjedhor, do të jetë edhe më i fuqishëm brenda strukturave të partisë. Ky realitet do të reflektojë edhe në jetën institucionale", ka thënë nënkryetari i PDK-së, Bajrush Xhemajli

EPOKA E RE Qendresa RAMA

Prishtinë, 29 janar - Instituti Nacional Demokratik (NDI), me eksperten amerikane të fushës së komunikimit dhe të folur para publikut, Jen Krim, të martën ka mbajtur trajnim me Gruan Demokratike të Kosovës, me temën "Komunikimi dhe të folurit para publikut".

Eksperten Jeen Krim fillimisht e ka pritur në zyrën e vet nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bajrush Xhemajli, i shoqëruar nga dy nënkryetarët e Gruas Demokratike të PDK-së, Arbnesha Kuçi dhe Hanife Salihu, ku kanë folur rreth bashkëpunimit të PDK-së me NDI-në dhe zgjedhjet e brendshme të PDK-së.

Nënkryetari Xhemajli ka falënderuar eksperten Jeen Krim, ndërsa ka shprehur mirënjohjen e tij ndaj NDI-së për bashkëpunimin e saj që nga themelimi i PDK-së. Ai ka shtuar se PDK-ja ka pasur bashkëpunim me shumë organizata në fushën e trajnimeve, por se NDI-ja ka lënë gjurmë në këtë parti dhe se me bashkëpunimin me këtë organizatë PDK-ja është fuqizuar.

Duke folur rreth zgjedhjeve të brendshme që është duke i zhvilluar PDK-ja, nënkryetari Bajrush Xhemajli ka thënë se procesi zgjedhor është duke ecur mirë, ndërkaq ka theksuar se pas procesit zgjedhor Gruaja Demokratike do të jetë më e fuqishme. "Gjykuar sipas rezultateve dhe informatave që kemi nga kuvendet e nëndegëve, pozicioni i gruas, pas përfundimit të procesit zgjedhor, do të jetë edhe më i fuqishëm brenda strukturave të partisë. Ky realitet gjithsesi do të reflektojë edhe në jetën institucionale", është shprehur Xhemajli.

Ndërsa ekspertja nga NDI-ja, Jeen Krimm, ka thënë se po sheh potencial politik si në Gruan Demokratike ashtu edhe në Rininë Demokratike. "Është kënaqësi të bashkëpunoj me këto grupe brenda strukturave të PDK-së, pasi aty shoh potencial të lartë për kultivimin e vlerave demokratike brenda subjektit politik" ka theksuar Jeen Krimm. Të hënën ekspertja Jeen Krimm nga NDI-ja ka zhvilluar trajnim edhe me Rininë Demokratike të PDK-së.

Kirurgët trajtojnë vetëm rastet urgjente

Prishtinë, 29 janar - Kanë kaluar gjashtë javë prej kur mjekët kirurgë në Kosovë janë në grevë. Greva ka ndikuar që brenda ditës të anulohen deri në 200 operacione, përderisa rastet urgjente vazhdojnë të trajtohen me kryerjen e rreth 50 operacioneve brenda 24 orëve.

Arbër Morina, kirurg, njëherësh përfaqësues i Kolegjiumit të Kirurgëve, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se, ndonëse shumë operacione joemergjente po anulohen, këto që janë kërcënuese për jetën e pacientëve po kryhen pavarësisht prej grevës. "Kërkesa jonë është rregullimi i koeficientit të pagave të specialistëve të Republikës së Kosovës. Gabimi është se për shëndetësinë e Kosovës asnjëherë nuk kanë vendosur ekspertë që janë të thirrur për këtë çështje. Njëzet vjet pas luftës po përsëriten gabimet. Fakti që dikush tjetër po vendos për koeficient për mjekët është një fakt i gabuar dhe nuk mund të kalojë. Derisa ne mjekët specialistë nuk konsultohemi për këtë ligj, ai është i gabueshëm", ka thënë Morina.

Ngjashëm me disa sektorë të tjerë publikë nëpër të cilët punonjësit po kërkojnë rritje të pagave, edhe kërkesa e kirurgëve është rritja e pagave përmes miratimit të Projektligjit për pagat, i cili aktualisht është në procedurë të miratimit në Kuvendin e Kosovës. Federata Sindikale e Shëndetësisë ka organizuar grevë më 26 dhjetor e cila kishte zgjatur 72 orë dhe më pas ishte ndërprerë, duke i dhënë mundësi dialogut social me Qeverinë e Kosovës. Megjithëkëtë, kirurgët thonë se nuk janë përfaqësuar denjësisht prej kësaj Sindikate, andaj kanë vazhduar grevën, duke mos përfillur sindikatën. Kryetari i Federatës Sindikale të Shëndetësisë, Blerim Syla, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se ai përfaqëson 14 mijë punëtorë shëndetësorë dhe se për grevën e kirurgëve nuk merr asnjë përgjegjësi, meqë nuk kanë pasur asnjë takim lidhur me këtë çështje.

UP-ja shënon ngritjen më të madhe në Webometrics, renditet e 1471-ta në botë

Qendresa RAMA

Prishtinë, 29 janar - Në përditësimin e fundit të publikuar nga ranglista prestigjioze e universiteteve botërore, Webometrics, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ka shënuar ngritjen më të madhe ndonjëherë, duke u radhitur në vendin e 1471-të në botë.

Në edicionin e janarit të këtij viti, Webometrics pasqyron ngritjen e UP-së për 1662 pozita më lart që nga viti 2018, kur UP-ja zinte vendin e 3133-të në botë në mesin e rreth 30 000 universiteteve të radhitura.

Bazuar në publikimin e Webometrics, UP-ja radhitet në vendin e 565-të në Evropë, ndërkaq del në vendin e tetë në radhitjen e universiteteve në rajon, duke lënë prapa vetes Universitetin e Nishit, të Sarajevës, të Shkupit, të Tiranës etj. UP-ja, sipas rezultateve të Webometrics, vazhdon të jetë lider i arsimit të lartë në hapësirën shqipfolëse.

Për rektorin e UP-së, Marjan Dema, ngritja e UP-së paraqet lajmin më pozitiv për arsimin e lartë.

Sipas tij, UP-ja po vazhdon fuqishëm ta përmirësojë radhitjen botërore të saj.

Dema këtë sukses ia atribuon stafit akademik të UP-së, teksa për këtë arritje përgëzon organet drejtuese dhe menaxhuese, stafin administrativ dhe studentët e UP-së. "Shumë profesorë tanë kanë punuar jashtëzakonisht shumë që t'i kontribuojnë hulumtimit në disiplinat e tyre akademike, gjë e cila shpërfaq aftësitë dhe dedikimin e tyre për universitetin, mund i cili rezultoi me një sukses të tillë për UP-në dhe vendin tonë", ka thënë Dema.

Përparimi i UP-së në këtë drejtim është edhe si rezultat i punës së Zyrës për Kërkime dhe Projekte të Sponsorizuara, e themeluar në vitin 2018, e cila ka objektiv mbështetjen e kërkimit dhe financimin e projekteve të stafit akademik. UP-ja në këtë drejtim është përkrahur edhe nga partnerë të tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Webometrics është një prej radhitjeve më të rëndësishme botërore, i zhvilluar nën përkujdesjen e Këshillit të Lartë të Kërkimit Shkencor (Consejo Superior de Investigaciones Cientificas - CSIS), me qendër në Madrid, njësi e Ministrisë së Edukimit të Spanjës.



Cybermetrics është një ranglistë jofitimprurëse e cila "nuk pranon pagesa për përfshirje në rangim, as oferta për reklamim të ndonjë universiteti".

Kosova shënon ngecje në luftën kundër korrupsionit

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 29 janar - Rezultatet e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2018 e zhvendosin Kosovën prapa në ranglistën botërore. Kjo u bë me dije të martën në konferencën për media të mbajtur nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), degë e "Transparency International" - rrjetit global në luftën kundër korrupsionit, në të cilën u publikuan rezultatet e këtij indeksi.

Me këtë rast Fjolla Uka nga KDI-ja ka theksuar se, sikurse në vitet e kaluara, edhe këtë vit Transparency International (TI) ka publikuar rezultatet e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit, i cili përdor një metodologji të sofistikuar shkencore.

Burime të informatave për këtë hulumtim janë kryesisht raportet kredibile nga organizata ndërkombëtare si Freedom House, World Bank, Bertelsmann Foundation, Global Insight dhe Varieties of Democracy Project. Indeksi shfrytëzon sistemin e vlerësimit prej 100 shkallësh në të cilin vlerësimi maksimal do të thotë "vend i pastër nga korrupsioni", kurse vlerësimi prej zero pikësh do të thotë "vend shumë i korruptuar". Uka ka njoftuar se në nivel global, prej 180 vendeve që marrin pjesë në këtë vlerësim, Danimarka radhitet e para këtë vit me 88 pikë, duke kaluar lideren e vjetëm, Zelandën e Re, e cila ka 87 pikë.

Vendin e tretë e ndajnë Finlanda, Singapori, Suedia dhe Zvicra me 85 pikë.

Arben Kelmendi ka thënë se Kosova sivjet ka humbur dy pikë në sistemin e vlerësimit të CPI (nga 39 sa kishte më 2017, në 37 pikë) dhe, si rrjedhojë, ka rënë nga pozita e 85-të në atë të 93-të. "Kosova me 37 pikë ende ndodhet nën mesataren globale prej 43 pikësh. Radhitja e Kosovës në indeksin e sivjetmë u atribuohet kryesisht institucioneve të brishta të sundimit të ligjit, nivelit të lartë të mosndëshkueshmërisë së rasteve të korrupsionit, mungesës së llogaridhënies së zyrtarëve publikë, transparencës së pamjaftueshme dhe ngushtimit të hapësirës për pjesëmarrje qytetare", ka shtuar ai.

Një gjetje tjetër interesante nga krahasimi i rezultateve për vendet e rajonit tregon se i tërë rajoni po kalon nëpër një periudhë ngecje dhe vetëm Maqedonia ka shënuar rritje prej dy pikësh në krahasim me vitin e kaluar. Kapja e shtetit përbën njërën prej pengesave kryesore për luftimin e korrupsionit dhe vendosjen e drejtësisë.



Sipas KDI-së, Kosova duhet të fokusohet urgjentisht në tri fusha në mënyrë që të shënojë përparim: Ndërhyrjet politike në punën e gjyqësorit po minojnë pavarësinë dhe punën profesionale të drejtësisë së Kosovës.

Arben Kelmendi ka shtuar se lufta kundër korrupsionit, pavarësisht prej ndryshimeve të fundit të legjislacionit, krijimit të grupeve punese dhe mekanizmave përcjellës për krimet e nivelit të lartë të korrupsionit, luftimi i korrupsionit vazhdon të mbetet një nga sfidat kryesore të shoqërisë së Kosovës. "Institucionet vendore nuk duhet të vetëmjaftohen nga sinjalet pozitive të institucioneve të BE-së për progresin e shënuar në këtë fushë. Të gjitha hulumtimet serioze flasin për nivele të larta të nepotizmit, punësimit në baza partiake, emërimeve politike në borde të ndërmarrjeve publike etj. Në fushën e prokurimit publik kërkohet ngritja e transparencës në të gjitha fazat e procedurës së prokurimit, hapja e kontratave, menaxhimi i mirëfilltë i kontratave publike dhe ngritja e nivelit të llogaridhënies së zyrtarëve publikë", ka shtuar Kelmendi.

LV-ja kundër privatizimit të Telekomit

Prishtinë, 29 janar (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, dhe drejtuesi i Komitetit për Komunikime Elektronike dhe Postare, Fatban Bunjaku, u takuan me kryetarin e Sindikatës së Telekomit të Kosovës, Lamih Balaj, dhe anëtarët e kryesisë, Shpëtim Zharku dhe Naim Haliti. Në takim u bisedua rreth vendimit të Qeverisë për nisjen e procesit të privatizimit, moszbatimin prej gjashtë muajsh të Rezolutës së Kuvendit dhe situatës së punëtorëve. "Qeveria nuk ka pasur as interesimin dhe as vullnetin për ta zgjidhur krizën e sajuar brenda Telekomit. Kontrata abuzive me Z-mobile, keqmenaxhimi dhe shfrytëzimi brutal i kapaciteteve të ndërmarrjes për interesa krejtësisht private duhen zgjidhur nga institucionet e Kosovës. Për këtë nuk duhet të ketë kompromis. Përfshirja e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) në vlerësimin e gjendjes së ndërmarrjes, me kusht nisjen e procesit të privatizimit për Telekomin, është i papranueshëm", është bërë me dije në komunikatën e Lëvizjes Vetëvendosje.

Sipas kësaj lëvizje, problemeve të menaxhimit Qeveria po i qaset a thua se ato janë fakt i dhënë, i pandryshueshëm. "Mbipunësimet partiake në Telekom nuk i shkaktuan punëtorët profesionistë, por segmente të partive të pushtetit. Bordet drejtuese cilësisht të dobëta, pa integritet u emëruan e votuan nga të njëjtët. Vijimin e kontratës abuzive me Z-mobile po e paraqesin si fatalitet, ndërkohë që kanë përgjegjësitë dhe instrumentet për ta ndalur", është thënë në këtë komunikatë.

Sindikalistët i njoftuan përfaqësuesit e LV-së se nga viti 2008 Telekomi i ka paguar Qeverisë 530 milionë euro dividentë. "Investime strategjike nuk bëhen, lidhen kontrata abuzive, paguhen shpenzime marramendëse, punësohen persona me lista, kurse në funksionin e auditit të

brendshëm vendosen familjarë të pushtetarëve. Drejtori i parafundit i Telekomit e gjeti këtë ndërmarrje me rëndësi ekonomike e strategjike me 48 milionë euro në thesar dhe e la me 200-300 mijë euro dhe me borxhe të panumërta që paraqiten me procedura përmbarimi. Sindikalistët shtuan që edhe sot në Telekom ka gra e burra të shkëlqyer e të zotë në profesionet e tyre, një pjesë e të cilëve prej rrethanave po zgjedhin largimin nga vendi. Republikës sonë nuk i mungojnë burimet njerëzore me nivel të lartë profesionalë brenda Kosovës e në mërgatë. Në mungesë dhe vonesë është vendimmarrja racionale qeveritare, ndershmërisht e guximshme, për ta shkapur Telekomin", është theksuar në komunikatën e Lëvizjes Vetëvendosje.

Matoshi pret në takim zyrtarë të BB-së, flasin për projektet në fushën e ajrit

Prishtinë, 29 janar (ER) - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka pritur të martën në takim menaxheren e projektit mbi cilësinë e ajrit, Kseniya Lvovsky dhe eksperten Klas Sander, me të cilat ka biseduar në lidhje me projektin e ajrit që Banka Botërore po realizon në Kosovë.

Ministri Matoshi ka prezantuar veprimet që MMPH-ja është duke ndërmarrë për reduktimin e ndotjes së ajrit si dhe ka vlerësuar projektin e ajrit që Banka Botërore është duke realizuar në Kosovë. "Krahas angazhimeve tona si task forcë për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe si ministri është i rëndësishëm dhe mirëpresim çdo studim dhe projekt që bëhet në fushën e ajrit, prandaj presim që t'i kemi rezultatet e këtij studimi dhe bashkë të punojmë për përmirësimin e cilësisë së ajrit në vend", ka thënë ministri Matoshi.

Ndërsa menaxherja e projektit të Bankës Botërore, Kseniya Lvovsky, ka deklaruar që si bankë janë në fazën finale të realizimit të studimit mbi cilësinë e ajrit në vend, duke prezantuar edhe mënyrën e realizimit të studimit. "Banka Botërore në vitin 2018 ka filluar projektin për studimin krahasues në lidhje me ndotjen e ajrin në tri shtete, Kosovë, Maqedoni dhe Bosnje Hercegovinë, duke krahasuar nivelin e ndotjes, pasojat shëndetësore dhe aspektin ekonomik të ndotjes. Tani jemi në fazën finale të përfundimit të studimit dhe në muajin shkurt të këtij viti do t'i kemi rezultatet finale", ka thënë Lvovsky.

Ministri Matoshi dhe ekspertet e Bankës Botërore u zotuan se do ta forcojnë bashkëpunimin për realizimin e projekteve të përbashkëta në fushën e mbrojtjes së ajrit nga ndotja.

Komisioni për Administratë Publike miraton Projektligjin për pagat

Me Projektligjin për pagat, përveç presidentit, nuk do të ketë zyrtar tjetër të lartë që do të marrë pagë të përjetshme, pasi Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media ka kufizuar në pesë vjet afatin kohor përgjatë të cilit, kryeparlamentari, kryeministri dhe prokurorët do të marrin paga. Ndërkaq, koeficienti i pagave është zbritur nga 12 në 10

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 JANAR - Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media ka miratuar të martën amendamentet e Projektligjit për paga për sektorin publik, ku ka miratuar edhe uljen e koeficienteve nga 12 sa ishte, në 10. Deputetët që janë anëtarë të këtij komisioni kanë votuar veç e veç amendamentet e këtij projektligji. Po ashtu, ky komision ka dërguar për në Kuvend edhe Projektligjin për zyrtarët publikë si dhe Projektligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura. Me Projektligjin për pagat, përveç presidentit, nuk do të ketë zyrtar tjetër të lartë që do të marrë pagë të përjetshme, pasi Komisioni për Administratë Publike ka kufizuar në pesë vjet afatin kohor përgjatë të cilit, kryeparlamentari, kryeministri dhe prokurorët do të marrin paga.

Kryetari i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Nait Hasani, ka thënë se ka kërkesë nga kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, që të ketë paga të përhershme për disa pozita të caktuara pas përfundimit të mandatit në pozitën përkatëse. "Kam kërkesë nga kryetari i Kuvendit që për kryeparlamentarin, kryeministrin, për kryeprokurorin e shtetit, prokurorin e Gjykatës Supreme dhe prokurorin e Gjykatës Kushtetuese, të jetë një pagë e përhershme me afat të kufizuar për pesë vjet", ka thënë ai.

Gjatë shqyrtimit të amendamenteve, Hasani ka thënë se të gjitha agjencive të cilat financohen nga shteti, përfshirë edhe RTK-në, duhet t'u përcaktohet niveli i pagave, të cilat nuk mund ta kalojnë vlerën e pagës së presidentit të vendit. Deputetët patën dilema për përkufizimin e RTK-së si televizion shtetëror në kornizën e Ligjit për buxhet. Deputetja Xhvahire Izmaku ka thënë se në këtë mënyrë komisioni ka thyer konceptin e shtetit për media të lira. Kurse Rasim Selmanaj ka thënë se RTK-ja duhet të hiqet nga Projektligji për pagat në sektorin publik. Në votimin e këtij projektligji katër vota kanë qenë për, katër kundër dhe dy vota abstenime. Përkundër kësaj, amendamenti ka shkuar në Kuvend pa përkrahjen e Komisionit.

Mosmiratimi i buxhetit për vitin 2019, shqetësues

Prishtinë, 29 janar (ER) - Komisioni për Buxhet dhe Financa ka mbajtur të martën mbledhjen e rregullt, të kryesuar nga Safete Hadërgjonaj, nënkryetare, në të cilën është miratuar raporti vjetor i punës për vitin 2018 si dhe plani vjetor i punës për vitin 2019.

Anëtarët e komisionit janë pajtuar t'i rekomandojnë kryesisë së Kuvendit që në seancën e radhës të futet në rend të ditës si pikë e parë shfrytëzimi i linjave buxhetore për muajin janar, pasi ende nuk është miratuar buxheti për vitin 2019. I pranishëm në mbledhjen e këtij komisioni ishte edhe ministri i Financave, Bedri Hamza.

Anëtarët e këtij komisioni kanë miratuar edhe raportin me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019. Po ashtu, anëtarët e këtij komisioni kanë miratuar edhe raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2018 si dhe kërkesën e Qeverisë lidhur me vendimin për ndryshimin e normës së tatimit të akcizës për duhanin.

Haradinaj pret në takim Florin Krasniqin, diskutojnë për investimet e diasporës

PRISHTINË, 29 JANAR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur në takim biznesmenin Florin Krasniqi i cili jeton në Amerikë. Me këtë rast, Haradinaj ka thënë se investimet e diasporës janë në interes të Kosovës. "Investimet e diasporës sonë, me potencial të madh financiar, janë me interes të jashtëzakonshëm për Kosovën. Prita në takim biznesmenin dhe investitorin kosovar që jeton në Amerikë, Florin Krasniqin, me të cilin pata kënaqësinë të bashkëbisedoj për impaktin e masave të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për krijimin e klimës së volitshme për investitorët", ka thënë pas takimit Haradinaj.

Florin Krasniqi në të kaluarën ka qenë deputet i Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin e Kosovës.



Kërkohet të veprohet urgjentisht për luftimin e trafikimit të narkotikëve në Gjilan

GJILAN, 29 JANAR (ER) - Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, Jetish Maloku, ka mbajtur të martën takim me zyrtarët përgjegjës policorë të sektorit për hetimin e trafikimit të narkotikëve në këtë komunë. Ky takim kishte për qëllim diskutimin dhe hartimin e planit të veprimit për luftimin, parandalimin dhe zbulimin e kryerësve të cilët janë të inkriminuar në veprat penale që lidhen me substanca narkotike.

Kryeprokurori Maloku ka theksuar se duke pasur parasysh se në regjionin e Gjilanit kjo dukuri negative ka shënuar rritje, Prokuroria Themelore në Gjilan ka caktuar prokurorin Shefik Memeti koordinator për hetimin e rasteve të kësaj natyre. Në këtë takim pjesëmarrësit u koordinuan që për këto raste të veprohet me urgjencë, sidomos kur janë të përfshirë recidivistët dhe me prioritet të veçantë të trajtohen rastet, në të cilat janë të përfshirë të miturit, pasi që situatë alarmante është përdorimi i mjeteve narkotike nga nxënësit në objektet shkollore.

Në fund të takimit pjesëmarrësit e vlerësuan lart bashkëpunimin reciprok, duke potencuar se në bazë të këtij koordinimi do të tejkalohen vështirësitë në drejtim të luftimit dhe parandalimit të kësaj dukurie, duke shprehur bindjen se takimet e tilla do të ofrojnë rezultate konkrete.

Edhe në Skenderaj do të hapet zyra për ndihmë juridike falas

SKENDERAJ, 29 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pritur të martën në takim drejtorin ekzekutiv të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, Ramadan Gashi dhe drejtoreshën e Departamentit për Shërbime Juridike Falas, Anita Alaj-Kalanderi, me të cilët ka diskutuar për projektin e kësaj agjencie që ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve juridike falas. "Edhe në Skenderaj do të hapet zyra për ndihmë juridike falas, projekti ky i mbështetur nga UNDP, pasi të përfundojnë procedurat e shpalljes së konkursit për pranim të një zyrtari, me qëllim që qytetarëve t'u ofrohet ndihmë juridike krejtësisht falas. Ramadan Gashit i dhurova stemën e komunës në shenjë respekti dhe vlerësimi për kohën që ishte në krye të Komunës së Skenderajt në periudhën e pasluftës, e cila ishte e shkatërruar pothuajse e gjitha", ka thënë kryetari Jashari.

Marrëveshje për realizimin e projekteve në sektorët e kulturës, rinisë dhe sportit

PRISHTINË, 29 JANAR (ER) - Nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Muhedin Nushi, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Hoti, për ta rritur bashkëpunimin ndërinstitucional në mënyrë që të përforcohen kapacitetet intelektuale, kulturore e sportive të rinisë sonë.

Secila palë, duke iu përmbajtur detyrave dhe qëllimeve të përcaktuara me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Republikën e Kosovës, pajtohet ta inkurajojë dhe promovojë bashkëpunimin në këto fusha: shkëmbimin e përvojave dhe mbështetjen e ndërsjellë për projektet rreth rinisë, kulturës dhe sportit; aranzhimin e përbashkët të aktiviteteve që kanë për synim grumbullimin e donacioneve ndërkombëtare për projektet që promovojnë kulturën dhe sportin; angazhimin e përbashkët rreth ecurisë dhe mbajtjes së garave sportive, të diturisë dhe kreativitetit kulturor si në nivelin shkollor, komunal dhe atë qendror; ndërhyrjen në infrastrukturën sportive duke ofruar bashkëpunim për zhvillimin e garave. "Secila palë angazhohet që me qëllim të përmbushjes së objektivave të përcaktuara në marrëveshje, ta ofrojë bashkëpunimin dhe mbështetjen profesionale, logjistike dhe asistencë financiare për zbatimin e projekteve nga fushat e parapara të bashkëpunimit", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Prishtinës.

Komuna e Mitrovicës dhe IADK vazhdojnë t'i mbështesin fermerët

MITROVICË, 29 JANAR (ER) - Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, ka pritur të martën në takim drejtorin ekzekutiv të IADK-së, Zenel Bunjaku, me ç'rast kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së projekteve bujqësore të realizuara nga IADK-ja në Komunën e Mitrovicës. Me këtë rast, nënkryetari Mujka ka falënderuar IADK-në, veçanërisht drejtorin Bunjaku, për bashkëpunim të ndërsjellët dhe të frytshëm, falë të cilit në bujqësinë e komunës janë realizuar një varg projektesh të rëndësishme që kanë ndikuar në shtimin e interesimit të fermerëve për t'u marrë me bujqësi.

Ndërkaq drejtori ekzekutiv i IADK-së, Zenel Bunjaku, e vlerësoi të suksesshëm bashkëpunimin me Komunën e Mitrovicës dhe premtoi se IADK do të vazhdojë t'i mbështesë projektet nga fusha të ndryshme të fermerëve mitrovicas.

Edhe drejtori i Bujqësisë, Ekrem Sadiku, ka falënderuar drejtorin Bunjaku dhe organizatën e tij për këtë bashkëpunim kaq të rëndësishëm për fermerët e Mitrovicës. "Falë IADK-së në Komunën e Mitrovicës janë realizuar shumë projekte të rëndësishme të cilat kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve në ekonomitë bujqësore dhe shtimin e interesimit të fermerëve për t'u marrë me bujqësi", ka thënë drejtori Sadiku.

Komuna e Mitrovicës do ta bëjë bashkëfinancimin e projektit në vlerë prej 20 përqindësh të investimeve nga projekti, ta mbështesë procesin e zbatimit të projektit, do të ofrojë përkrahje profesionale, ta lehtësojë mbajtjen e trajnimeve dhe këshillave për të gjithë përfituesit.

Defaktorizimi i Kosovës shqiptare, interes vetëm i Serbisë

- Çlirimi i Kosovës

Xhevat BISLIMI

Veprimtaria politike e çlirimtare e Lëvizjes Popullore të Kosovës kulmoi me organizimin e luftës së armatosur kundër Serbisë pushtuese. Formacioni i armatosur u emërtua nga Kryesia e LPK-së më 17 nëntor 1994: Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Me Kosovë, LPK-ja dhe Lëvizja Kombëtare përgjithësisht, kuptonte të gjitha trevat e pushtuara shqiptare nga Jugoserbia. Përpjekjet dhe lufta e UÇK-së fituan simpatinë dhe përkrahjen e mbarë kombit shqiptar pa dallim ideje, partie, krahine e feje. Përjashtim nga ky unitet bënte ndonjëri nga krerët partiakë dhe grupe e qarqe me "deformime" të theksuara kombëtare. Ky unitet politik dhe kombëtar me kohë fitoi simpatinë dhe përkrahjen e botës perëndimore-demokratike. Fuqitë e Mëdha u bindën se lufta e kombit shqiptar për çlirimin e krahinave të pushtuara të Shqipërisë nuk mund të frenohej dhe as të kornizohej. "Flakët e kësaj lufte, siç deklaronte edhe kryetari i Amerikës, Klintoni, rrezikonin ta digjnin edhe Evropën". Kryetari amerikan e dinte nga teoria e Vattelit, që në ligjin ndërkombëtar "fuqia ose dobësia... nuk do të thoshte gjithçka. Një xhuxh mund të jetë po aq i fuqishëm sa një gjigant. Një republikë e vogël mund të jetë po aq e fuqishme sa edhe një mbretëri e fuqishme". Teorinë e Vattelit e ka "vulosur" praktikisht Shqipëria e vogël e shek. XV me luftën e saj kundër Perandorisë më të fuqishme të kohës..., por në ballë të saj kishte kryetrimin dhe kryestrategun, të famshmin, Gjergj Kastriotin. Kjo teori u bë e saktë edhe në kohën tonë. Republika e vogël e Shqipërisë, e udhëhequr nga Enver Hoxha, u përballë suksesshëm me Perandorinë Ruse dhe me presionet e kërcënimet e ekonomike, politike e ushtarake të fqinjëve shovinistë dhe aleatëve të tyre të mëdhenj. Një shembull tjetër ishte edhe lufta e Finlandës së vogël kundër Perandorisë sovjetike-ruse...

Këtu edhe duhet kërkuar arsyeja dhe shkaku themelor i ndërhyrjes së NATO-s, e cila e "kornizoi" luftën e UÇK-së e të kombit shqiptar dhe e përfundoi atë me largimin e plotë të forcave pushtuese serbe nga ajo që quhej dhe përkufizohej si "krahina autonome e Kosovës". Trevat e tjera mbetën të pushtuara dhe të copëtuara nga republikat e dikurshme të Federatës Jugosllave.

Po të kufizohemi edhe ne, vetëm në atë që nga Jugoserbia ishte definuar si "krahina autonome e Kosovës", mund të themi, pa pasur frikë se gabojmë, se fitorja ishte e plotë. Forcat pushtuese serbe dhe administrata serbe ishin dëbuar tërësisht nga territori i Kosovës me kufijtë e imponuar nga Beogradi...

Vendosja e Kosovës nën kontrollin ndërkombëtar

Hileja iu bë Kosovës dhe kombit shqiptar me vendosjen e Administratës së OKB-së (UNMIK), e cila zëvendësoi administratën serbe me qëllim që të privoheshin fitimtarët e luftës nga e drejta për ta krijuar administratën e Kosovës dhe për ta qeverisur atë. Shkaktare e të gjitha konflikteve dhe luftërave në Iliri ishte Serbia. Këtë e pohojnë dhe "miratojnë" të gjitha vendet demokratike. Nëse ishte kështu, atëherë pse vendosej Kosova nën "tutelën" ndërkombëtare në vend se të vendosej Serbia luftënxitëse dhe përgjegjëse për shkatërrim e djegie të vendeve tjera dhe për krime, gjenocid e holokaust? Kur e kishin pyetur Kryetarin amerikan, Harry Truman, se për çfarë do të donte të mbahej mend ishte përgjigjur: "Ne mundëm tërësisht armiqtë tanë dhe i bëmë të dorëzoheshin. Më pas i ndihmuam të ngriheshin në këmbë dhe u mësuam demokracinë. Pastaj i ndihmuam të bëheshin pjesë e bashkësisë së kombeve. Vetëm Amerika mund ta bënte këtë gjë" (Cituar sipas librit "Pushtet dhe parajsë" të autorit Robert Kagan, f. 119). Pse nuk u veprua kështu me Serbinë luftënxitëse, që u mund, u dorëzua, por nuk iu mësua demokracia dhe nuk u ndihmua të bëhej pjesë e bashkësisë së kombeve të qytetëruara!... Apo pse prapa Serbisë qëndronte Rusia e ndonjë vend tjetër i fuqishëm? Mospajtimet dhe divergjencat e faktorit ndërkombëtar për pavarësimin-shkëputjen e plotë të Kosovës nga Serbia ishin maksimale, por më kryesorja dhe më vendimtarja për luftën dhe për proceset e pa luftës ishte polarizimi dhe përçarja e brendshme, mungesa e unitetit politik e kombëtar!...

Vendosja e Kosovës shqiptare nën kontrollin ndërkombëtar e "problematizonte" shkëputjen dhe pavarësimin e plotë të Kosovës nga Jugoserbia... Hileja e këtij "misioni" ndërkombëtar u pa që në ditët e para. Krahas çarmatosjes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës zhvillohej projekti për ndarjen e Veriut (gati një e katërta e territorit) nga Kosova! Forcat ushtarake franceze (me emblemën KFOR!) mbyllën urën që bashkonte Mitrovicën dhe Veriun. Ky ishte sinjal (nëse jo marrëveshje e fshehtë!) që të gjithë serbët e inkriminuar të vendoseshin në Veri, nga njëra anë, ndërsa shqiptarët nuk do të lejoheshin, për shkaqe sigurie(!), të ktheheshin në shtëpitë dhe pronat e tyre në pjesën veriore të Mitrovicës dhe në vendbanimet tjera në Veri! Për shqiptarët që kishin mbetur andej ose për shqiptarët që kishin "guxuar" të ktheheshin në shtëpitë e tyre rrugëve pa rrugë, në kundërshtim me "vullnetin" e forcave të KFOR-it francez dhe të strukturave kriminale serbe, u organizua terrori për vrasjen dhe dëbimin e tyre! Për ata që kishin dy bërthama në kokë mesazhi dhe projekti ishte i qartë: Veriu, me përkrahjen e pakursyer të KFOR-it, UNMIK-ut dhe OSBE-së (edhe organizata e shërbime tjera të "pa deklaruara!), po (ri)vendosej nën kontrollin e Serbisë! Ky projekt, bashkë me "krijimin e enklavave serbe, që më vonë u bënë komuna e zona të mbrojtura(!), kishte për qëllim, siç u vërtetua e po vërtetohet përditë e më shumë, "bosnizimim" e Kosovës shqiptare, me qëllim të fundit: ndalimin e bashkimit (siç u ndalua formalisht edhe me kushtetutë!) të kësaj krahine me Trungun - shtetin e saj, Republikën e Shqipërisë, dhe mbajtjen e saj të lidhur pas qerres serbe!...

"Bosnjëzimi" i Kosovës

Projekti për "bosnjëzimin" e Kosovës shqiptare po shtyhej përpara me harbutri të paparë nga prania ndërkombëtare dhe nga qendra e qarqe të fuqishme ndërkombëtare, në bashkëpunim të ngushtë me klasën politike vendore! Logjika e presionit dhe shantazhit mbi të dobëtin po vepronte pamëshirshëm mbi Kosovën e lodhur nga robëria e gjatë dhe nga mizoritë e pushtuesit! Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte privuar nga drejtimi politik (eliminimi i LPK-së!) qysh gjatë Luftës! Menjëherë pas çlirimit (dëbimit të forcave pushtuese) UÇK-ja u la në "spontanitetin" e saj! Ai që u vetëquajt "kryekomandant" po bredhte nëpër Evropë, ndërsa Shtabi i Përgjithshëm ishte krejt jashtë "loje" dhe nën ethet e fitores! Harruan apo nuk e dinin fare, ata që kishin "përvetësuar" komandimin dhe drejtimin e UÇK-në, se lufta më e vështirë për Kosovën fillonte me të mbaruar Lufta! Komandanti i Përgjithshëm i UÇK-së, i "zgjedhur" gjatë kohës së bombardimeve, nuk përfillej ose nuk ishte i zoti ta kontrollonte UÇK-në e pas Luftës! Mbase, sipas mendjes së tij dhe eprorëve tjerë, lufta kishte përfunduar! Komandantët e zonave e të njësiteve ishin të 'lirë" të silleshin e të vepronin sipas rastit e dëshirës! Për ndjekjen e njësiteve serbe (tashmë në rroba civile) nga Veriu as që mendohej!...

Kreu i LDK-së, që ishte këmbë e krye kundër Luftës Çlirimtare, me lejen e Millosheviqit-Serbisë, kishte dalë në Evropë të bënte fushatë kundër bombardimeve të NATO-s e tash nuk po kthehej! Ndërkohë, me vonesë, u kthye edhe "kryekomandanti" nga Evropa. Nuk vonoi e në Kosovë mbërrini, pasi mori "garancitë" e duhura, edhe kreu i LDK-së. Mirëpo, Qeveria e Përkohshme vazhdonte të bojkotohej nga kreu i LDK-së, I. Rugova, i cili duhet të mbahet si përgjegjësi kryesor për përçarjen politike dhe për dëmin e madh që pati populli shqiptar në Kosovë për shkak të kolaborimit të tij e të strukturave të LDK-së me pushtuesin dhe "bojkotimin" e Luftës Çlirimtare. Të dy "krahët", ai i luftës dhe ky i kolaborimit, nuk ia dolën të merreshin vesh as pas mbarimit të Luftës për pavarësimin e plotë të Kosovës nga Serbia. Mirëpo, të njëjtit, kreu i krahut të LDK-së dhe kreu i krahut të Luftës, po merreshin vesh për bukuri dhe po i nënshtroheshin pa kushte UNMIK-ut, KFOR-it dhe qendrave që kontrollonin Kosovën! Klasa e vjetër politike, e brumosur me ideologji dhe frymë jugotitiste, dhe klasa e re "patriotike", e trimëruar dhe harlisur me luftën fitimtare, vazhdonin t'i shpenzonin energjitë e tyre në grindje, sherre e përplasje ndërmjet vete, nga njëra anë, dhe duke i shërbyer me "besnikëri" pranisë ndërkombëtare dhe projektit të tyre për një"Kosovë autonome e multietnike"!... Pra, nuk ia dolën të përmbushnin detyrën historike që shtrohej para tyre: bashkimin politik për shpëtimin e Kosovës shqiptare, duke i ofruar partneritet të fuqishëm pranisë ndërkombëtare dhe duke u bërë mur i pakalueshëm për projektin e "bosnjëzimit" të Kosovës dhe rikthimit të Serbisë në çfarëdo forme a mënyre qoftë. Prandaj, janë fajtorë e përgjegjës, kush më shumë e kush më pak, para kombit dhe para historisë... Kryetari (Presidenti) Alfred Moisiu e paralajmëronte këtë "fatkeqësi" në gazetën "Tribuna Shqiptare", të datës 9 korrik 1999: "...në qoftë se politikanët shqiptarë në Kosovë, nuk do të jenë në gjendje të menaxhojnë, me aftësi dhe zgjuarsi situatën atje, qëndrimi i tyre mund të ketë pasoja... e rëndësishme është të dimë të merremi vesh njëri me tjetrin. Përçarjet dhe mosmarrëveshjet vetëm na dëmtojnë. Ato u japin më shumë shanse kundërshtarëve tanë dhe paksojnë tonat". Një muaj më vonë, në të njëjtën gazetë, Moisiu konkludonte se "Kosova e pavarur është tashmë e vetmja zgjidhje e pranueshme jo vetëm për shqiptarët, por në të njëjtën kohëmundësia më reale e zgjidhjes së problemit". Në analizën e Tij, Moisiu e vë theksin te domosdoshmëria e marrëveshjes dhe unitetit politik... "Kjo arrihet vetëm duke qenë të bashkuar në qëllime. Ndryshe, duke u marrë me sherre të brendshme, jo vetëm nuk do të jemi në gjendje të ndjekim situatën dhe të drejtojmë problemet tona, por do të bëhemi të bezdisshëm edhe për miqtë tanë më të mirë". Siç edhe u bëmë të bezdisshëm edhe për miqtë tanë!! "Shansi na ka ardhur duhet shfrytëzuar, vazhdon Moisiu. Këtë nuk e themi vetëm ne shqiptarët, këtë po na e thonë edhe miqtë tanë. Më shumë, më bukur dhe më hapur nuk kanë se ç'të na thonë. T'i urojmë vetes mend, urtësi, bashkim dhe fat, për të mirën e Kosovës, për të mirën e çështjes shqiptare". Pra, miqtë tanë nuk ishin kundër shkëputjes dhe pavarësimit të plotë të Kosovës nga Serbia pas luftës (dy-tri vitet e para). Rasti më i mirë ndoshta ishte menjëherë ose përnjëherë me shkëputjen dhe pavarësimin e Malit të Zi nga Jugoserbia. Por, politikanët shqiptarë të Kosovës kishin shqetësime tjera më të "rëndësishme"!... **(Vijon)**

Intervistë me veprimtarin e çështjes kombëtare, autorin e librit monografik "Goli Otoku, histori e trishtë e një krimi shtetëror jugosllav", Meriman Braha

GOLI OTOKU, KRIMI QË S'HARROHET KURRË

Unë nuk kam qenë në burgun e Goli Otokut dhe angazhimi im për të shkruar për këtë burg e llogore nuk ka të bëjë asgjë me kujtimet e përjetimet e mia, por ka të bëjë me një përpjekje për të ndriçuar anët e errëta të shtetit jugosllav dhe të sistemit të tij tipik totalitar dhe diktatorial për një periudhë shumë të gjatë kohore. Gjatë kësaj periudhe të diktaturës jugosllave shteti ka bërë një sërë krimesh shtetërore ndaj qytetarëve të vet, një sërë krimesh mbi bazën ideologjike dhe një sërë krimesh mbi bazën etnike, krime këto që kanë mbetur të heshtura, mjeshtërisht të kamufluara para syve të botës, duke u shitur si shtet socialist me fytyrë humane



Intervistoi: Sadik ZEQIRI

"EPOKA E RE": *Në vitin e kaluar botuat librin "Goli Otoku, histori e trishtë e një krimi shtetëror jugosllav", i cili i ka munguar shumë historisë shqiptare dhe të gjitha atyre në Ballkan. Çfarë dokumentesh keni publikuar në këtë libër?*

BRAHA: Libri "Goli Otoku, histori e trishtë e një krimi shtetëror jugosllav" është një përpjekje për t'i dokumentuar krimet e një shteti, në këtë rast të Jugosllavisë, mbi qytetarët e vet. Goli Otoku është, në fakt, dëshmi e dokumentueshme e një prej krimeve më monstruoze të shtetit jugosllav, të ideuar, të planifikuar dhe të realizuar me të gjithë aparaturën e dhunshme të shtetit, duke u lëshuar nga kupola më e lartë shtetërore jugosllave, nga Byroja Politike, qeveria jugosllave, veçanërisht Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes e deri te poret më të imta shoqërore. Në libër janë sjellë dokumente autentike të UDB-së federative dhe të asaj kroate, dëshmi të shumta rrëqethëse të personave që kanë përjetuar golgotën e Goli Otokut, dëshmi të ubashëve që kanë ushtruar dhunë të organizuar brenda llogorit, dëshmi të udhëheqësve të llogorit dhe të tërë sistemit represiv të llogoreve e burgjeve të Jugosllavisë. Veçanërisht i rëndësishëm është dokumenti i UDB-së federative me listën e shifruar të të burgosurve në Goli Otok me rreth 17 000 emra. Ky dokument ka rëndësi të veçantë sepse në listën e madhe përfshihen të dhënat për personat e dënuar, datëlindja, vendlindja, kombësia, organi që e ka burgosur, data e burgosjes, lloji i dënimit, lartësia e dënimit, data e lirimit dhe lloji i vendimit për lirim. Dokumenti është autentik dhe dërgohet nga UDB-a federative UDB-së së Kroacisë për ta saktësuar, plotësuar apo korrigjuar. Në këtë dokument të rëndësisë së dorës së parë për herë të parë jepet një shifër e të burgosurve politikë në Goli Otok, sepse aty të gjithë ishin të burgosur politikë, përmbledhur në harkun kohor prej 1949 deri në vitin 1961, pra për dymbëdhjetë vjet. Në libër merret në trajtim pikërisht ky hark kohor, 1949-1961 që është, në fakt, koha e veprimeve më të egra shtetërore mbi ata që u quajtën armiq të popullit e të shtetit, që nga themelimi i llogorit e hapja e tij në korrik të vitit 1949. Janë shfrytëzuar dokumente nga Arkivi Shtetëror i Kroacisë edhe për njerëzit që kanë vdekur ose që janë vrarë në llogor, gjithnjë të këtij harku kohor. Në veçanti kam hulumtuar për shqiptarët që janë vrarë në torturë, për disa prej tyre dihet edhe vendi i varrimit dhe numri i varrit, disa janë pa varr, por edhe pa dosje, domethënë u është zhdukur dosja, siç është rasti me Omer Çerkezin, një figurë e shkëlqyer atdhetare, që vdes në mënyrën më barbare, trupin e dërrmuar të të cilit e hedhin natën në det, duke i lidhur një gur të rëndë për trupi.

"EPOKA E RE": *Keni vepruar shumë për çështjen kombëtare shqiptare në vitet '68, '80 e më vonë. Po për këto aktivitete keni mbajtur disa vjet burgim dhe jeni burgosur disa herë. E keni kaluar ndonjë ditë të burgut në Goli Otok dhe çfarë ju kanë thënë dëshmitarët për këtë burg që kanë ndenjur më gjatë?*

BRAHA: Jo, nuk kam vuajtur dënime në Goli Otok, ndërsa kam dëgjuar shumë për vuajtjet e të burgosurve në atë ishull. Kam pasur në rrethin shoqëror dhe miqësor shumë persona që kanë qenë atje. Bisedat e tyre për ato që i kanë përjetuar atje kanë qenë mjaft të kufizuara deri në vitin 1966, pas rënies së Rankoviqit, që ishte sinonim i politikës së ashpër e represive. Pas kësaj kohe, sidomos pas vitit 1968, ata kanë filluar të flasin më hapur dhe bisedat kanë qenë më të thelluara. Me vëmendje të veçantë, si të rinj që ishim, i dëgjonim rrëfimet, ose copëza rrëfimesh nga Ali Aliu, Kadri Halimi, Ukë Ukimeraj, Nezir Gashi, Masar Shporta, Enver Dukagjini, Sami Peja etj. Secili rrëfente kujtimet e veta të asaj katrahure njerëzore dhe ne trishtoheshim dhe mbusheshim plot mllef për ato ngjarje e ditë të rënda e të këqija që kishin përjetuar. Ishte karakteristike se ata flisnin me admirim për qëndresat e shokëve dhe kurrë nuk dëgjonim prej tyre mburrje dhe aq më pak vetëmburrje.

Dënoheshin për këto dy lloje të veprave...

"EPOKA E RE": *Për çfarë dënoheshin dhe burgoseshin njerëzit në Goli Otok?*

BRAHA: Të gjithë të burgosurit e Goli Otokut kanë qenë të burgosur politikë deri në kohën e rënies prej pushteti të Rankoviqit. Pas kësaj kohe janë përmirësuar kushtet e jetesës dhe burgu është përshtatur për të mitur, të veprave të ndryshme penale, ndërsa në vitet '80 atje kanë vuajtur dënimet edhe shumë të burgosur politikë shqiptarë që ishin pjesë e lëvizjes së përgjithshme kombëtare në Kosovë.

Në fund të viteve '40 e deri në fund të viteve '50 të burgosurit politikë ishin dy llojesh kryesore: të dënuar për vepra penale politike kundër popullit dhe shtetit nga gjykatat e rregullta; dhe të dënuar me masa administrative, që nuk dënoheshin nga gjykatat e rregullta, por nga disa lloj këshillash të vendit, të qytetit, të lagjes e nga sektorë të veçantë të UDB-së etj. që të gjithë në koordinim të plotë me organet e brendshme shtetërore, por asnjeri i kualifikuar dhe i autorizuar për gjykimin e njerëzve.

Nëse për kategorinë e parë zhvilloheshin hetimet, organizohej gjykimi dhe shpallej publikisht një Aktgjykim me kohëzgjatjen e dënimit, që zakonisht ishin dënime të rënda; për kategorinë e dënuarve me masën administrative nuk kishte aktgjykime, as aktvendime, as vendime, përveç në raste të rralla. Burgosjet dhe dënimet me masën administrative kishin të njëjtat procedura si ato të hetimeve të rregullta, me përdorimin e dhunës e të torturës në formë të pakontrolluar, por që të dënuarve u shqiptohej dënimi gojarisht, që sillej nga 12 deri në 60 muaj, ndërsa për të drejtën e ankesës as që bëhej fjalë. Në Goli Otok, të gjithë të burgosurit, si ata që ishin dënuar për vepra penale politike, ashtu edhe ata që ishin dënuar me masën administrative, pa ndonjë veprim konkret, por që supozoheshin si armiq të mundshëm, kishin të njëjtin trajtim bestial, qoftë në hetimet e vazhdueshme me tortura individuale apo kolektive, mungesë ushqimi, me punën tepër të rëndë, si formë speciale e torturës, me gjumë totalisht të çrregulluar dhe me mungesë të plotë të kontaktit me familjet, pa letra, pa pako dhe pa vizita. Për të burgosurit politikë të Goli Otokut familjet mund të merrnin informata vetëm në zyrat e UDB-së në qendrat prej nga ishin, që zakonisht përmblidheshin në formën: "është mirë, në duart tona është, s'ka nevojë për asgjë, sepse ne i japim të gjitha". Familjet as që kanë qenë të njoftuara se në cilin burg janë, sepse opinioni i gjerë nuk ka pasur dijeni për hapjen e një llogoreje të veçantë për të burgosurit politikë të asaj kohe.

"EPOKA E RE": *Pse duhej të dërgoheshin në atë ishull, përplot me gurë, mijëra veta për ta vuajtur një dënim të shkurtër kohor?*

BRAHA: Llogorja e Goli Otokut është ngritur me qëllim të grumbullimit të armiqve politikë të Jugosllavisë, në veçanti për ata që kishin rënë ndesh me politikën e Jugosllavisë përballë kampit socialist të udhëhequr nga Bashkimi Sovjetik, të kohës së Informbyrosë. Por, siç thashë dhe më parë, ata që kishin rënë ndesh me politikën e Jugosllavisë dhe kishin vepruar, ishin dënuar nga gjykatat, qofshin ato civile, qofshin ushtarake, ndërsa armiqtë e supozuar, ata për të cilët mungonte dëshmia e veprimit, por supozohej se mund të ishin mbështetës të fshehtë të Bashkimit Sovjetik, ose të ndonjë shteti satelit të tij, ndëshkoheshin me burg me masën administrative, pa procedurë gjyqësore dhe pa një aktgjykim dhe pa të drejtë ankese. Kjo formë e dënimit është veçanërisht e kundërligjshme, sepse shtrirja e zbatimit të kësaj mase ndëshkuese është tepër e gjerë dhe pa bazën e duhur juridike. Fakti se në llogoren e Goli

→

Otokut, në bazë të listës së madhe zyrtare të UDB-së federative, nga 17 000 persona të burgosur, 12 000 janë pa vendime gjyqësore, që kanë vuajtur dënime nga 12 muaj deri në 60 muaj. Secilit të dënuar me këtë masë ka mundur t'i zgjatet dënimi gojarisht deri në 60 muaj, pa ndonjë vendim dhe pa ndonjë arsyetim. Jeta e të burgosurve politikë në Goli Otok është ndërtuar mbi frikën, dhunën dhe pasigurinë totale gjatë tërë kohës së qëndrimit të tyre atje. Nëse dikujt i është kumtuar me gojë se dënohet me masën administrative, që shpjegohej me sintagmën "punë e dobishme shoqërore", me 12 ose 24 muaj, kjo s'kishte asnjë siguri se ai do të dilte ditën a datën e caktuar, sepse lirimi i tij varej kryekëput nga udbashët që zhvillonin hetimet shtesë në vetë llogoren famëkeqe. Gjatë kësaj kohe, nga grupi prej rreth 50 udbashësh, nga të gjitha republikat dhe federata, që ishin me detyrë zyrtare në ishullin e Goli Otokut, varej se çfarë kishin nxjerrë nga armiqtë e supozuar nën tortura për shokët ose anëtarët e tjerë të familjes, që zhvilloheshin në ambientet e hetuesisë, por akoma më shumë në ambientet e barakave, ku hetime shtesë bënin të burgosurit mbi të burgosurit. Hetuesit kishin duar plotësisht të lira dhe disponinin tërësisht me jetën e të burgosurit. Ata ishin atje me detyrë shtetërore për t'ia nxirë sa më shumë jetën secilit dhe këtë e kanë bërë me shumë sukses, duke ushtruar mbi ta 65 lloje torturash nga më monstruozet, që janë të listuara në libër.

Në Goli Otok u vranë edhe shqiptarë

"EPOKA E RE": *Goli Otoku, sa ishte burg për shqiptarë, po aq ishte edhe për serbë, kroatë, sllovenë, malazezë, maqedonas, hungarezë, bullgarë, italianë etj. Na intereson të dimë nëse është pushkatuar ndonjë shqiptar në Goli Otok dhe me çfarë akuze?*

BRAHA: Sipas hulumtimeve të bëra, në bazë të dokumenteve që kam pasur në dorë, në Goli Otok janë katër shqiptarë të vrarë në torturë dhe një i vrarë në tentim për ikje. Vetëm për Fetah Bajram Klunën, nga Drenasi, jepet shpjegimi se është vrarë në tentim ikjeje, ndërsa për të tjerët nuk jepen shënime se cila ka qenë arsyeja e vdekjes, prandaj mund të supozojmë se ata janë vrarë në torturë, veçanërisht duke pasur parasysh seancat e torturave publike në baraka, ku ishin në veprim personat e UDB-së të infiltruar si të burgosur politikë dhe që ushtronin dhunë fizike në mënyrë sistematike mbi të tjerët. Shqiptarë të evidentuar në listën e të vdekurve, që ruhet në Arkivin Shtetëror të Kroacisë, janë këta: Martin Vaso Gjoka nga Tuzi, 18 vjeç, nuk dihet vendvarrimi; Nikolla Luc Perkaj, 28 vjeç, nga Tuzi, i varrosur në Miroshevac/Zagreb; Qemal Hysen Hoxha, 30 vjeç, nga Gjakova, i varrosur në Mirogoj/Zagreb; Fetah Bajram Kluna, 36 vjeç, nga Drenasi, i varrosur në Bileqe dhe Omer Ibrahim Çerkezi, 35 vjeç, nga Mitrovica, nuk ka shënime për arsyen e vdekjes e as për vendin e varrimit.

"EPOKA E RE": *Kush tjetër prej familjes suaj ka qenë i burgosur në burgjet e ish-Jugosllavisë dhe në Goli Otok?*

BRAHA: Në këtë kohë kur ishte hapur dhe vepronte llogorja për të burgosurit politikë antijugosllavë, familja ime, baba, nëna dhe pesë fëmijë të mitur, si dhe disa familje të tjera shqiptare, është internuar në një kamp të punës së detyrueshme në Vojvodinë. Në këtë lloj kampi internimesh ne kemi hasur në një numër tepër të madh gjermanësh që, gjithashtu, ishin të internuar, më vonë u deportuan dhunshëm për në Austri dhe Gjermani. Në kushte dhe rrethana tepër të vështira, të vendosur edhe në stallë lopësh, familja ime ka kaluar katër vjet në internim. Gjatë internimit babën e kanë burgosur dhe e kanë mbajtur rreth gjashtë muaj në burgjet e Beogradit. Pas internimit babai ka qenë prapë i burgosur dhe ka qëndruar mbi një vit e ca, pastaj Qemali, vëllai im, më vonë vëllai tjetër, Salajdini, i cili nën tortura ka pësuar infarkt, nipi Arsimi, mbesa Fatmirja, mbesa Valbona. Kështu që kemi përvojë të madhe me veprimet e armiqve të popullit tonë.

Unë nuk kam qenë në burgun e Goli Otokut dhe angazhimi im për të shkruar për këtë burg e llogore nuk ka të bëjë asgjë me kujtimet e përjetimet e mia, por ka të bëjë me një përpjekje për të ndriçuar anët e errëta të shtetit jugosllav dhe të sistemit të tij tipik totalitar dhe diktatorial për një periudhë shumë të gjatë kohore. Gjatë kësaj periudhe të diktaturës jugosllave shteti ka bërë një sërë krimesh shtetërore ndaj qytetarëve të vet, një sërë krimesh mbi bazën ideologjike dhe një sërë krimesh mbi bazën etnike, krime këto që kanë mbetur të heshtura, mjeshtërisht të kamufluara para syve të botës, duke u shitur si shtet socialist me fytyrë humane.

(Vijon në numrin e ardhshëm të gazetës)

E rrallë

Zbulohet qilari i lashtë egjiptian i verës

Arkeologët kanë zbuluar një qilar vere të lashtë greko-romak në veri të kryeqytetit të Egjiptit, Kairo. Monedha të periudhës Ptolemaike, fragmente të veprave të qeramikës dhe mozaikut, edhe një dizajn i sofistikuar arkitektonik për kontrollin e temperaturave brenda qilarit duke përdorur lloje dhe forma të ndryshme të gurëve, ishin ndër artefaktet që zbuluan.

FOTO E DITES



Një pamje ajrore tregon qytetin norvegjez të Tromsës në rrethin arktik. /AFP/

E jashtëzakonshme

Gruaja ngecën në ashensor gjatë gjithë fundjavës

Një grua është shpëtuar pasi kaloi fundjavën e bllokuar në ashensorin e punëdhënësit të saj miliarder. Marites Fortaliza hyri në ashensorin në lagjen Manhattan në pronësi të bankierit të investimeve Warren Stephens të premten në mbrëmje. Zjarrfikësit iu përgjigjën thirrjes së urgjencës të hënën në orën lokale 10:00 dhe hapën ashensorin me forcë.

KINO ABC PRISHTINE

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.
Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers

Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.
Regjia: Donovan Marsh

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	LIVERPOOL - LEICESTER	4+	TOTTENHAM - WATFORD	1	REAL BETIS - ESPANYOL	3+

Drejtuesit e FC Vushtrria: Deklaratat e Tahirit, të pavërteta

Drejtuesit e FC Vushtrria nga Liga e Parë e Kosovës në futboll kanë hedhur poshtë pretendimet e ish-portierit të tyre, Petrit Tahiri, për mosrespekt nga ana e drejtuesve të klubit. Ata bëjnë me dije se kryesia e klubit i çmon shumë lojtarët vushtrrias, por edhe të tjerët që luajnë për këtë klub. Drejtuesit e Vushtrrisë janë të bindur se kjo skuadër edicionin tjetër do të bëjë gara në IPKO Superligën e Kosovës në futboll

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 JANAR - Një nga heronjtë e titullit të fituar me skuadrën e Vushtrrisë në rangun elitar të futbollit në Kosovë, Petrit Tahiri, është larguar nga kjo skuadër duke treguar për "Epokën e re" se nuk është respektuar sa duhet nga drejtuesit e klubit. "Trajtimi joserioz ndaj meje, pas marrjes së vendimit nga kryesia pa arsye, që ta shkelë kontratën për të ma zvogëluar pagën, më ka nxitur ta lë këtë ekip. Nuk është se varem nga paga e futbollit, sepse për Vushtrrinë shumë raste kam luajtur edhe pa asnjë cent si, për shembull, kemi luajtur dhjetë muaj pa pagesë dhe jemi shpallur kampionë të Kosovës. Thjesht, është në pyetje karakteri dhe krenaria ime", ka thënë Tahiri.

Portierit në fjalë i janë kundërpërgjigjur drejtuesit e klubit. Sipas tyre, deklaratat e portierit Tahiri nuk qëndrojnë dhe se klubi ka një trajtim mjaft të mirë për futbollistët vushtrrias, por edhe të tjerët. "Drejtuesit e Klubit Vushtrria e demantojmë deklaratën e Petriti, pasi kontrata në gjashtëmujorin e parë i është përmbushur dhe për gjashtëmujorin e dytë e kemi futur në rishqyrtim dhe ai nuk e ka pasur të obliguar refuzimin apo pranimin e saj. Petritit nuk i ka pëlqyer kjo dhe ka kërkuar largimin. Ne si drejtues të klubit e kemi lënë të lirë të gjejë një ekip të ri. Gjithashtu, nuk është e vërtetë se nuk i kemi trajtuar mirë lojtarët e Vushtrrisë, pasi pjesa dërrmuese e ekipit është nga Vushtrria. Kemi lojtarë me emër në futbollin e Kosovës si Labinot Osmani, Ilir Izmaku dhe të tjerë që i trajtojmë në mënyrën më të mirë, ashtu sikurse edhe lojtarët që vijnë nga qytetet e tjera", thuhet në reagimin e drejtuesve të Klubit Vushtrria.

Drejtuesit e klubit kanë bërë me dije se ata nuk e kanë për obligim drejtimin e këtij klubi, por se këtë e bëjnë në mënyrë vullnetare, në të mirë të qytetit të Vushtrrisë. "Ne e bëjmë krejt në mënyrë vullnetare, pasi kemi dëshirë t'i përkrahim këta djelmosha që ta rikthejnë klubin në Superligë. Qyteti i Vushtrrisë e do shumë futbollin dhe ne si kompani kemi menduar të ndihmojmë në rrugëtimin drejt rikthimit në Superligë. Në krye me presidentin Naser Imerin jemi vërtet në rrugën më të mirë për të hyrë në Superligë, pasi jemi edhe liderë të pakontestueshëm në tabelë falë punës së trajnerit, ndihmësve të tij dhe drejtorit sportiv. Andaj ne presim përkrahjen e qytetit siç e kanë dëshmuar deri më tani dhe Superliga është gjithmonë e më afër nesh", thuhet në reagimin e drejtuesve të skuadrës nga Vushtrria.

Katër klube të Kosovës në garat ndërkombëtare

"Pas rezultateve të mira që kemi pasur me ekipin përfaqësues, kemi bërë kërkesë që kampionati ynë të vlerësohet dhe të ngrihet në nivel më të lartë, pasi konsiderojmë se nuk jemi në nivel me disa shtete që i kanë ligat shumë më të dobëta", ka thënë Agim Ademi, kryetar i Federatës së Futbollit të Kosovës

PRISHTINË, 29 JANAR - Në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës për të tretin vit radhazi është mbajtur seminari për licencimin e klubeve për garat e UEFA-s. Kryetari i FFK-së, Agim Ademi, fillimisht i ka falënderuar përfaqësuesit e klubeve për organizim shumë të mirë në stinorin vjeshtor dhe ka theksuar se tashmë të gjitha klubet janë të vetëdijshme për rëndësinë dhe peshën që ka licencimi për gara evropiane. "Deri më tash kemi qenë mirë sa i përket licencimit të klubeve, por duhet të vazhdojmë të punojmë me përpikëri në të gjitha segmentet. Pas rezultateve të mira që kemi pasur me ekipin përfaqësues, kemi bërë kërkesë që kampionati ynë të vlerësohet dhe ngrihet në nivel më të lartë, pasi konsiderojmë se nuk jemi në nivel me disa shtete që i kanë ligat shumë më të dobëta. Pra, qëllimi ynë është që kampionati ynë të vlerësohet më lart, në mënyrë që të rritet numri i ekipeve që do të jenë pjesë e garave evropiane. Por, për ta arritur këtë duhet të kemi rregullsi dhe cilësi të garave, pastaj infrastrukturë më të mirë dhe organizim të mirëfilltë të ndeshjeve", ka thënë Ademi, i cili ka shtuar se barra kryesore për organizim dhe cilësi u bie klubeve.

Numri një i FFK-së do ta bëjë punën e vet dhe se nuk do të tolerohet asnjë gabim. "E kam thënë edhe më parë dhe po e përsëris, se nuk do ta fal asnjë gabim. Ato të paqëllimtat do t'i sanksionojmë në mënyrë sportive me organet tona, kurse gabimet e qëllimta do t'ia delegojmë Këshillit Kombëtar Kundër Dukurive Negative në Sport. Në këtë mënyrë do të ecin përpara ekipet më cilësore dhe kësisoj do t'ua ruajmë investimet njerëzve që po investojnë në futboll", ka shtuar Ademi.

Menaxheri i licencimit, Bajram Shala, zëvendëssekretari i përgjithshëm, Arianit Ahmeti dhe eksperti financiar, Indrit Canolli, i kanë njoftuar klubet për procesin e licencimit si dhe për risitë në këtë segment. Menaxheri i licencimit, Bajram Shala, ka njoftuar klubet se edhe sivjet skuadra kampione do të marrë pjesë në raundin parakualifikues që zhvillohet me katër ekipe. Ai ka bërë me dije se FFK-ja sivjet ka aplikuar që ta marrë organizimin e këtij raundi në mënyrë që t'i krijojmë kushte sa më të mira klubit kampion që ta përfaqësojë Kosovën sa më mirë dhe ta ketë përkrahjen e tifozëve.

Sot Kosova përballet me Bjellorusinë

PRISHTINË, 29 JANAR - Përfaqësuesja A në futsall është akomoduar në Bjellorusi, aty ku do t'i zhvillojë ndeshjet kualifikuese për Kampionatin Botëror. Ndeshjen e parë të përzgjedhurit e Ramadan Cimilit do ta zhvillojnë sot (mërkurën) në orën 18:30 kundër skuadrës nikoqire të kualifikimeve të Grupit B, Bjellorusisë. Një ditë më pas Kosova do të përballet me Norvegjinë, në orën 17:00, kurse ndeshjen e tretë e zhvillon më 2 shkurt kundër Andorrës, në orën 9:15. Dy skuadrat e para në renditje kalojnë në rrethin e ardhshëm kualifikues. Përfaqësuesja, para udhëtimit në Bjellorusi, ka qenë e grumbulluar në Gjakovë, ku ka stërvitur për një javë rresht në mënyrë që të jetë sa më e përgatitur për këtë cikël kualifikues.

Lista e lojtarëve: Alfred Prenqi, Jeton Rukovci, Taulant Rusinovci, Drilon Paçarizi, Arbër Dobroshi, Vahid Krasniqi, Mërgim Dervishaj, Shpend Brahimi, Oso Gjinovci, Bajram Ramadani, Fadil Goli, Dardan Topilla, Nexhip Selimi, Ramadan Alaj.

Xhemaili nuk largohet nga Bologna, Parma kërkon Hetemajn

Veronë, 29 janar - Mefushori Blerim Xhemaili nuk do të largohet nga skuadra e Bolognas, pasi kjo skuadër e sheh shumë të rëndësishëm futbollistin shqiptar. Lajmi është konfirmuar nga "calciomercato.com". Një tjetër mesfushor shqiptar mund të ndërrojë skuadër në Serinë A. Bëhet fjalë për Përparim Hetemajn, i cili po kërkohet nga skuadra e Parmës. Aktualisht Hetemaj është pjesë e Chievo Veronas por, pasi e ka humbur vendin e titullarit, mund të ndërrojë skuadër në këtë afat kalimtar. Kontrata e tij me Chievon është e vlefshme deri më 2020, por Parma është e gatshme t'i ofrojë Chievos një milion euro dëmshpërblim për Hetemajn.

Futbollistët nga Uruguai dhe Salvadori përforcojnë Lirinë

Prizren, 29 janar - KF Liria është përforcuar me dy futbollistë të huaj. Përmes faqes zyrtare në "Facebook", Liria ka bërë me dije se është përforcuar me mesfushorin e majtë nga Uruguai, Martins Pio, si dhe me qendërmbrojtësin Riascos Jhonny nga Salvadori. "Në kuadër të përgatitjeve për edicionin pranveror, sot (e martë) Liria ka prezantuar dy transferimet e reja. Ata janë: Martins Aristegui Maickol Pio me origjinë nga Uruguai, që luan mesfushor i majtë dhe që vjen nga Al-Nabi Sheet Club nga Libani dhe Riascos Jhonny, qendërmbrojtës që vjen nga klubi Deportivo Dragon nga Salvadori", thuhet në njoftimin e Lirisë.

Prezantimin e bënë anëtarët e Bordit të klubit, Nuredin Qollaku dhe Besim Xhambazi. "Përvoja e tyre e madhe, prej nga vijnë, do t'i ndihmojë ekipit. Presim edhe dy ardhje të reja, në ndërkohë që të plotësohemi si skuadër", ka thënë për faqen e klubit, trajneri Vincenzo Alberto Annese. Një ditë më parë "bardhezinjtë" prezantuan edhe dy futbollistët e ardhur nga Venezuela, mesfushorët: Ramirez Valdivia Guillermo Abel, i ardhur nga klubi Margarita FC dhe Jimenez Vivas Luis Manuel nga klubi Gran Valencia FC.

Golden State bën ligjin në Perëndim, fitojnë edhe Bostoni dhe Denveri

Oakland, 29 janar - Skuadra kampione e Golden States marshon drejt kreut të renditjes në Konferencën e Perëndimit, pas fitores 132-100 në fushën e Indianas, fitorja e 11-të radhazi në NBA. Takim i dominuar nga basketbollistët e Warriorsit, që u shkëputën që në fillim, sfidë ku u dalluan Curry me 26 pikë e Cousins me 22. Të njëjtin ritëm ruan edhe Denveri, ndjekësi më i afërti i Golden States, që mundi 95-92 Memphisin në fushën e këtij të fundit. Miqtë dominua në ndeshje, por në fund rrezikuan shumë. Jokiqi realizoi 24 pikë e Bartoni 20. Për vendësit u dalluan Gasoli me 28 pikë e Conley me 23 pikë e 11 asistime, por që mbetën për statistikë. Fiton edhe skuadra e Bostonit, që mundi pa shumë mund 112-104 Brooklynin, sfidë që ngjit ekipin e Celticsin në vendin e pestë në Lindje. Smart dhe Brown realizuan nga 21 pikë secili për Bostonin, duke i bërë të pavlefshme 25 pikët e Russellit për Brooklynin, raporton "Telesport". Në ndeshjet e tjera të luajtura sot, skuadra e Atlantës

befasoi Clippersin, duke triumfuar 123-118 në Los Angeles. Young realizoi 26 pikë, Collins 22, duke fituar duelin me Harrisin, që shënoi 30 pikë për kalifornianët. Skuadra e Charlottes, falë një loje të mirë kolektive (6 lojtarë realizuan mbi 10 pikë), fitoi 101-92 ndaj New Yorkut.

REZULTATET

Charlotte - New York	101-92
Indiana - Golden State	100-132
Boston - Brooklyn	112-104
Memphis - Denver	92-95
Clippers - Atlanta	118-123

SHKURT

Murray ende dëshiron të luajë në "Wimbledon"

Tenisti britanik Andy Murray, fitues i tre grand slemeve në karrierë, ka vendosur t'i nënshtrohet një operacioni në pjesën e sipërme të kofshës në mënyrë që ta vazhdojë karrierën. Para grand slameve të "Australian Open", ish-numri një në botë tha se mund të tërhiqet që pas këtij turneu, por duket se 31-vjeçari ka ndryshuar mendje. Në këtë turne Murray u eliminua që në raundin e parë. Murray i është nënshtruar operacionit, lajm që tenisti britanik e ka konfirmuar përmes një fotoje të publikuar në rrjetet sociale. Me këtë operacion ai ka qëllim jo vetëm rikthimin e tenistit në fushë, por edhe faktin se ai dëshiron të bëjë një jetë më të mirë, pa shqetësime fizike. Nuk dihet ende se sa kohë tenisti do të qëndrojë pushim pas këtij operacioni. "Kreva një ndërhyrje kirurgjikale në Londër. Ndihem pak i lodhur dhe kam dhimbje, por shpresoj se ky operacion t'i japë fund shqetësimit që kam me trupin tim. Tani, në pjesën e sipërme të kofshës, kam një metal", u shpreh Murray, që ka si objektiv të luajë në grand slam të shtëpisë së vet, në "Wimbledon".

Llapi mposhti Drenicën

Dy skuadrat e IPKO Superligës së Kosovës në futboll, Llapi dhe Drenica, e kanë zhvilluar sot një miqësore në Durrës. Fituese në këtë ndeshje doli skuadra e Llapit, kurse golin e vetëm në këtë ndeshje e realizoi mesfushori Mentor Zhdrella në fund të pjesës së parë.

Benatia nga Juve kalon tek Al Duhaili

Medhi Benatia nuk është më pjesë e Juventusit. Mbrojtësi maroken u largua nga "Zonja e vjetër" pas dy sezoneve e gjysmë të luajtura me të, për ta vijuar karrierën në Katar, pikërisht te skuadra e Al Duhail. Kampionët e Italisë zyrtarizuan largimin e futbollistit në drejtim të Al Duhail për shumën e tetë milionë eurove, të cilën klubi nga Katari do ta paguajë në dy këste brenda tetorit të vitit 2019. Medhi Benatia ka zhvilluar 40 ndeshje në Serinë A me Juventusin, duke shënuar tre gola, i fundit prej të cilëve ishte ai ndaj Romës në dhjetor të vitit 2017.

Mbrojtësi kroat kërkohet nga Interi dhe Roma

Pas shumë tentativash në vitet e kaluara, janari mund të jetë koha e duhur për zbarkimin e Domagoj Vidas në Serinë A. Mbrojtësi kroat, i cili ka një kontratë deri në vitin 2022 me Besiktasin, kërkohet nga Interi dhe Roma, skuadra të cilat kanë nevojë për përforcime në këtë repart. Zikaltrit e shikojnë si pasuesin e Mirandas, nëse ky largohet menjëherë, ndërsa verdhekuqtë duan ta përforcojnë ndoshta pikën më të dobët të ekipit për këtë vit. Formula e transferimit të 29-vjeçarit do të ishte ajo e huazimit me të drejtë blerjeje 10 milionë euro.

Quagliarella rikthehet në kombëtare

Fabio Quagliarella po kalon një moment magjik në karrierë. Edhe pse 36 vjeç, "Mr dreamgoal", ashtu siç thërritet nga tifozët për shkak të golave të bukur që realizon, ka marrë një ftesë nga trajneri i kombëtares së Italisë, Roberto Mançini. Ai deri më tani ka shënuar 16 gola në kampionat duke udhëhequr me një gol më shumë se Cristiano Ronaldo listën e golashënuesve në Itali. Quagliarella rikthehet në kombëtare pas katër vjetësh mungesë. Hera e tij e fundit ka qenë në vitin 2015, kur kombëtarja drejtohej nga Konte. Sulmuesi numëron 25 paraqitje me Italinë, duke realizuar edhe shtatë herë. "Axurrët" po përgatiten për ndeshjet e marsit në kundër Finlandës dhe Liteshteinit, në kuadër të "Euro 2020".

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)-Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)-The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Në bazë të nenit 8 parag. 1 e 2 e Ligjit të Punës Nr. 03/L-212; nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik; nenit 13 pika 1 dhe 3 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinike Universitar i Kosovës, (SHSKUK); mbështetur në nenet 62 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125; Nenit 5, parag. 1 e 2 e Rregullores, Nr. 1003/2016 mbi marrëdhënien e punës; si dhe Kërkesa (E-maili) e datës 23.01.2018, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, shpall:

KONKURS

Institucioni: Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Titulli i punës:	Zyrtar i Lart i Prokurimi (3 pozita në SHSKUK)
Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Kategoria funksionale/Grada:	8.4.
Nëpunësi mbikëqyrës:	Shefit të Sektorit të Prokurimit në SHSKUK,
Kohëzgjatja:	Me kohë të pa/caktuar
Vendi:	Sektori i Prokurimit në SHSKUK
Nr. i Referencës:	SHSKUK - 04/2019-1/3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit të Lartë të Prokurimit:

Departamenti i prokurimit/njësia përveç obligimeve tjera do të ketë edhe përgjegjësitë në vijim:

a) Të siguroj kërkesat e parashikuara të materialeve shpenzuese dhe jo-shpenzuese, përfshirë parashikimet e kostos, për secilin vit fiskal, nga të gjitha departamentet;
b) Në konsultim me të gjitha departamentet përgatit një plan vjetorë të prokurimit dhe vendos kërkesat sipas prioritetit. Kur është e mundshme siguron që artikujt e përdorimit të zakonshëm janë konsoliduar;
c) Siguron që mallrat, shërbimet dhe punët blihen në mënyrën më ekonomike, efikase dhe efektive;
d) Për aq sa mundet, siguron se ne specifikimet teknike nuk ka kufizime ne konkurrence;
e) Këshillon njësitë kërkuese, departamentet e përdorimit, për metoda dhe praktika individuale të prokurimit;
f) Në bashkëpunim me Udhëheqësit e Njësive kërkuese, Departamenteve të Përdorimit, përgatit dhe koordinon të gjitha dokumentet, specifikimet, TeR, Paramasat dhe Parallogaritë dhe vizatimet;
g) Përgatit dhe publikon mundësitë e tenderimit;
h) Përgatit dokumente parakualifikuese, dosje të tenderit, kushtet e kontratës, dhënien e kontratës, raportet e vlerësimit të tenderëve etj, duke përdorur formularët standard të aprovuar;
i) Para fillimit të aktivitetit të prokurimit siguron që fondet janë në dispozicion dhe të autorizuara me shkrim;
j) Organizon dhe menaxhon kuotimet dhe tenderët varësisht nga çmimi i parashikuar;
k) Organizon dhe menaxhon takimet para-ofertuese, hapjet e tenderëve dhe procesin e vlerësimit;
l) Rekomandon përbërjen e anëtarëve të Komisionit të Hapjes së Tenderëve/të Vlerësimit të Tenderëve;
m) Participon në Negocime të Tenderëve dhe siguron rezultate të drejta;
n) Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, shqyrton propozimin për kontratë të rekomanduar nga komisioni vlerësues;
o) Pranon/refuzon rekomandimin e propozuar;
p) Përgatit dhe publikon dhënien e kontratave;
q) Siguron që të regjistrohen te dhënat për pjesëmarrjen e OE-ve, procedurave dhe vendimeve të cilat janë marrë gjatë secilës fazë të procesit të prokurimit;
r) Monitoron ekzekutimin e Kontratave dhe Urdhëresave për Blerje, dhe siguron që kopje të të gjitha kontratave dhe urdhëresave për blerje të dërgohen në departamentin e financave dhe të pranimit;
s) Përcjellë dorëzimin e mallrave/shërbimeve/punëve sipas kushteve të kontratës;
t) Kur ndodhin mosmarrëveshje, dëme në mallra, dorëzime të tepërta ose të mangëta, dështim në përformimi ose komplikime tjera relevante, siguron se është mbajtur evidentimi detal i te gjitha komunikimeve dhe te dëshmive relevante;
u) Përcjellë dështimet e kontraktorëve të cilët kanë dështuar të përmbushin obligimet e tyre kontraktuale kurdo që informohet nga Menaxheri i Projektit në lidhje me kompensimet e duhura, likuidimin e dëmeve dhe aranzhimin e anulimit të kontratave;
v) Kontrollon faturat të jenë në përputhje me kontratën, shënimet e mallrave të pranuara, shënimet e dorëzimeve, mallrat në kthim etj, secila e nënshkruar nga zyrtarët e përcaktuar dhe në raste të arsyeshme, dorëzimin e certifikatës, aprovimin e komisionimit ose certifikatën e përfundimit të kontratës, nëse nuk është e rregulluar ndryshe ne Autoritetet kontraktuese;
w) Certifikon që të gjitha dokumentet e tilla janë korrekte dhe të plotësuara dhe i dërgon në departamentin për financa për ekzaminim përfundimtarë dhe procesim të faturave, nëse nuk është e rregulluar ndryshe ne Autoritetet kontraktuese;
x) Bashkëpunimi i ngushtë me Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe KRPP,
y) Dorëzimi i raporteve javore për punën e Sektorit të Shefi i Prokurimit,
z) Mirëmban dhe arkivon të dhëna për prokurime; dhe
aa) Prodhon një raport vjetor në fund të secilit vit fiskal.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit:

1. Diplomë universitare: Jurist ose Ekonomist;
2. Përvojë pune së paku pesë (5) vjet në Administratë;
3. Të ketë shkathtësi për të krijuar marrëdhënie të mira ndërpersonale;
4. Aftësi për të ndihmuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët;
5. Të ketë shkathtësi të krijimit të sistemit të raportimit,
6. Të ketë kompetence udhëheqëse me vizion për te identifikuar çështjet kryesore, strategjike, mundësitë dhe rreziqet, me aftësi të mëdha udhëheqëse.
7. Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë
8. Njohja e gjuhëve zyrtare në përdorim,
9. Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme.

Data e hapjes dhe mbylljes së konkursit: 15 ditë nga publikimi në njërën nga gazetat ditore.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave sipas konkursit në fjalë.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë, Zyra e Sektorit të Personelit në Objektin e Administratës, tel. nr. 045/145-135.
Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentacioni mbi kualifikimin, dëshmi përkatëse për përvojën e punës, si dhe dëshmi tjera të kërkuara në konkursin publik.

- ✓ Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.
- ✓ Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "TAK" Sh.P.K. me seli në Zveçan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 71179362 dhe nr. Fis:601283245 me pronar Gvozic Milos- ID 0256251 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillim-in e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavještavamo se svi klienti da Tvrtka "TAK" D.O.O u Zveçan , doneo odluku da ugasi biznis po br.registra: 71179362 fis: 601283245 Gvozic Milos, ID 0256251- I ujdno imenovao Likfidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se sci klienti imaju obaveze I potrazivanja u navedenjo firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company "TAK" L.L.C in Zveçan, has come to the decision to quit its business with registry 71179362, fisk: 601283245 Gvozic Milos, ID 0256251-The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager-mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)-Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)-The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Kadrovska Služba

Prema članu 8, tačka 1 i 2, Zakona o radu br. 03/L-212; člana 4 Administrativno Uputstvo (MRSZ) Br. 07/2017 o Regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru; Člana 13. tačka 1 i 3. Statuta Bolničke Službe i Univerzitetskog Kliničkog Centra Kosova (UBKSK), na osnovu člana 62 Zakona o Zdravstvu br. 04/L-125; Članu 5 tačka 1 i 2 Odredbe br. 1003/2016 o Radnim Osnosima; i Zahteva (E-maila) dana 23.01.2018, Generalni Direktor UBKSK, raspisuje:

K O N K U R S

Institucije: Universitetski Bolnicke i Klinicke Sluzbe Kosova (UBKSK)

Naziv radnog mesta:	Viši Službenik za Nabavke (3 pozicije u UBKSK)
Radno vreme:	40 sati nedeljno (puno radno vreme)
Funkcionalna kategorija / Grad:	8.4.
Nadzorni službenik:	Šef Sektora Nabavke u UBKSK
Trajanje:	Neodredjeno vreme
Lokacija:	Sektor Nabavke u UBKSK
Br. Referenca:	UBKSK - 04/2018-1/3.

Dužnosti i odgovornosti Viši Službenik za Nabavke:

:

a) obezbediti predvidene procene, za svaku fiskalnu godinu, od strane svih odeljenja;
b) su predmeti obične upotrebe konsolidovani;
c) obezbeđuje da se roba, usluge i radovi kupuju na najekonomičniji, efikasniji i efikasniji način;
d) u meri u kojoj to može osigurati da tehničke specifikacije nemaju ograničenja konkurencije;
e) savetuje jedinice koje zahtevaju, odeljenja za upotrebu, za individualne metode nabavke i prakse;
f) u saradnji sa šefovima Jedinice za traženje, Odeljenje za Upotrebu, priprema i koordinira sva dokumenta, specifikacije, TeR, Parame i Prognoze i crteže;
g) Pripremiti i objaviti ponude za ponude;
h) pripremiti pretkvalifikacione dokumente, tenderski dosije, uslove ugovora, dodelu ugovora, izvještaje o procjeni tendera itd., koristeći standardne odobrene forme;
i) Pre početka aktivnosti nabavke sredstva su dostupna i ovlašćena u pisanoj formi;
j) organizirati i upravljati ponude i ponude u zavisnosti od procenjene cene;
k) organizovati i upravljati sastanima pred održavanjem tendera, otvaranjem tendera i procesom evaluacije;
l) preporučuje sastav članova Komisije za procenu tendera / tendera;
m) učestvuje u pregovaračima o tenderima i osigurava poštene rezultate;
n) Nakon završetka procesa procene, razmotrite predlog za ugovor koji preporučuje komisija za evaluaciju;
o) prihvata / odbija predloženu preporuku;
p) priprema i objavljuje dodelu ugovora;
q) obezbeđuje da se evidentiraju podaci o učešću EO, procedura i odluka koje su preduzete tokom svake faze procesa nabavke;
r) pratiti izvršavanje ugovora i kupovnih naloga i osigurati da se kopije svih ugovora i kupovnih naloga šalju na odeljenje finansija i prijema;
s) vrši isporuku robe / usluga / radova u skladu sa uslovima ugovora;
t) Kada se dogovaraju neslaganja, oštećenje roba, otpuštanja ili nedostaci, neusaglašenost ili druge relevantne komplikacije, obezbeđuje se detaljna evidencija svih komunikacija i relevantnih dokaza;
u) sprovede propuste izvođača radova koji nisu ispunili svoje ugovorne obaveze kad god ih je informisao rukovodilac projekta u vezi sa odgovarajućim nadoknadom, likvidacijom štete i otkazivanjem ugovora;
v) Proverite fakture u skladu sa ugovorom, evidenciju primljene robe, evidenciju isporuke roba u povratku, itd, svaki potpisan od strane zvaničnika definisanim i opravdanim slučajevima, dostave potvrde, odobrenja puštanja ili potvrde o završetku ugovora, osim ako se ugovorni organi drugačije ne dogovore;
w) potvrđuje da su svi takvi dokumenti tačni i popunjeni i da ih šalju Odjelu za finansije za završni pregled i obradu faktura, osim ako se ugovorni organi ne dogovore drugačije;
x) Bliska saradnja sa telom za razmatranje javnih nabavki i RKJN,
y) Podnošenje sedmičnih izvještaja o radu Glavnog Sektora Nabavke,
z) održava i arhivira podatke o nabavkama; i
aa) Izrađuje godišnji izveštaj na kraju svake fiskalne godine.

Kvalifikacija, iskustvo, veštine i lične karakteristike, na osnovu specifičnosti institucije:

1. Universitetska Diploma: Pravnika ili Ekonomista;
2. Radno iskustvo najmanje pet (5) godina u Administraciji;
3. Imati sposobnost uspostavljanja dobrih međuljudskih odnosa;
4. Sposobnost pomoći i saradnje sa drugima;
5. Imaju sposobnost da kreiraju sistem izveštavanja,
6. Imaju vodeću nadležnost sa vizijom da identifikuju ključna pitanja, strateške, mogućnosti i rizike, sa velikim vodeću nadležnosti.
7. Imaju dokazane i efikasne vještine pisane i usmene komunikacije
8. Priznavanje službenih jezika u upotrebi.
9. Prepoznavanje kompjuterskog rada je imperativ.

Datum otvaranja i zatvaranja takmičenja: 15 dana od dana objavljivanja u jednom dnevnom listu.

Uslovi učešća u zapošljavanju: Svi građani Republike Kosova sa odraslom starosnom dobi koji imaju punu sposobnost da deluju, imaju adekvatno obrazovanje i imaju profesionalnu sposobnost da obavljaju dužnosti prema slobodnom stanu.

Podnošenje prijava: Prijave su primljene i dostavljene Univerzitetskom Kliničkom Centru Kosova u Prištini, Kancelarija Kadrovske Službe u Adminsitrativnoj zgradi, Tel. br. 045/145-135.
Aplikaciji se prilaže dokumentacija o kvalifikaciji, relevantnim dokazima radnog iskustva, kao i drugi dokazi koji se traže na javnom konkursu.

Zahtjevi poslati nakon poslednjeg datuma neće biti prihvaćeni. Nepotpuni zahtevi će biti odbijeni.
U slučaju velikog broja primljenih zahteva, kontaktiraće se samo odabrani kandidati na listi.

Generalni Direktor UBKSK.

Dr. Basri Sejdiu



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" Prizren
Pranuar me datë: 28.01.2019
Zyra e pranimit: 308 | Nr. i protokollit: 01-19/A

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren - Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. 19 Datë: 28/01/2019

Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren shpall:

KONKURS
PËR ANGAZHIMIN E PERSONELIT AKADEMIK NË BAZË TË NEVOJAVE TË NJËSIVE AKADEMIKE

Angazhimi me honorar i personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë, Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti", Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës nr. 03/L-212, dhe Rregulloreve të brendshme të universitetit.

a) Kushtet e përgjithshme për angazhim

1. Personeli i jashtëm akademik mund të angazhohet në UUHP për një periudhë të caktuar kohore, me qëllim të realizimit të veprimtarisë arsimore e shkencore mbi bazën e një konkursi publik për bashkëpunëtorë të jashtëm (me honorar). Angazhimi nuk nënkupton sipas këtij konkursi themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës e as pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.
2. Angazhimi me honorar i bashkëpunëtorëve të jashtëm bëhet në mënyrë transparente në përputhje me Rregulloren për Procedurat Vlerësuese për Angazhimin e Bashkëpunëtorëve të Jashtëm.

b) Fondi i orëve mbinormë (honorar) dhe kohëzgjatja e kontratës

1. Sipas nenit 14 të Rregullorës për të Ardhura Personale nr. 01-11/A të datës 18.01.2019, bashkëpuntorët e jashtëm – të angazhuarit dhe profesorët jasht UUHP-së, por me tituj të barazvlershëm në universitete publike, për ligjerata mund të mbajnë deri në 6 orë në javë. Përjashtimisht ligjeruesit e angazhuar në gjuhën turke dhe boshnjake mund të mbajnë deri në 8 orë në javë.
Bashkëpuntorë – të angazhuar për ushtrime (pa thirrje akademike në universitetet publike) mund të mbajnë deri në 8 orë në javë.

2. Kandidatët të cilët do të përzgjidhen në kuadër të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie dhe ushtrime, do të pajisen me kontrata pune me honorar (varësisht nga fondi i orëve që ka) për periudhën nga 15.02. 2019 – 15. 06. 2019 (15 ditë kompensohen për angazhim në procesin e provimeve).
3. Kompensimi do të bëhet në përputhje me raportin e orëve të realizuara gjatë semestrit të caktuar, i cili vërtetohet nga njësia akademike përkatëse, por jo më shumë se fondi i orëve i përcaktuar sipas rregullores në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik të UUHP-së. Kompensimi bëhet vetëm nga kategoria ekonomike paga dhe meditje.
4. Personeli i angazhuar që ka thirrje akademike: Prof. i rregullt, Prof. i asociuar; Prof. asistent dhe Ligjërues, përveç orëve të ligjëratave të mbajtura, i kompensohen edhe orët e ushtrimeve në raport 2:1 (2 orë ushtrime = 1 orë ligjëratë) në kuadër të normës së paraparë.
5. Në kuadër të kontratës me honorar është përfshirë edhe mbajtja e provimeve dhe angazhimet e tjera, si: konsultimet me studentë dhe mbajtja provime në tri afate të rregullta dhe deri në dy afate të jashtëzakonshme (nëse e lejon Senati).
6. Të gjitha kontratat e përkohshme të angazhimit me honorar do të jenë të bazuara në dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti", rregullores në fuqi për të ardhura personale të personelit akademik të UUHP-së dhe në Ligjin e Punës së Republikës së Kosovës nr. 03/L-212.
7. Një mësimdhënës mund të angazhohet për dy ose më shumë lëndë të së njëjtës fushë në njësitë akademike, duke mos e tejkaluar normën e plotë.

c) Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kërkesa për aplikim dhe CV-ja;
- Certifikata e lindjes;
- Certifikata penale (vërtetim nga gjykata që nuk jeni nën hetime);
- Kopja e diplomës përkatëse e noterizuar nga organi kompetent (kandidatët që kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet të sjellin edhe vendimin e nostrifikimit të diplomës përkatëse: bachelor, master/ magjistraturë, doktoraturë);
- Kandidatët të cilët aplikojnë për pozitën e asistentit, lektorit apo korepetitorit, duhet të sjellin edhe certifikatën e notave të studimeve bachelor dhe master;
- Dëshmi për publikime shkencore e profesionale, si dhe informata të tjera specifike shtesë;
- Dëshmi për angazhime në UUHP (nëse kanë qenë të angazhuar më parë) ose në ndonjë institucion tjetër (të akredituar) të arsimit të lartë;
- Kandidatët që nuk kanë shtetësi të Republikës së Kosovës, duhet të sjellin dëshminë e lejeqëndrimit. Nëse nuk kanë qëndrim rezident në Republikën e Kosovës, të sjellin një deklaratë nën betim që nuk janë banorë rezident në Republikën e Kosovës.
- Dëshmia për njohjen e gjuhëve të huaja (njohja e gjuhës angleze ose e ndonjë gjuhe tjetër të huaj përbën përparësi).
- *Stafi i rregullt akademik i universiteteve publike në Republikën e Kosovës të cilët shprehin interesin për angazhim në UUHP përveç dokumentacionit të përmendur më lart duhet të sjellin edhe leje-konfirmim nga ana e rektorit të Universitetit prej nga vijnë.*

I) FAKULTETI I EKONOMISË

1. **Një profesor për lëndën:** Kërkimet në Marketing.
2. **Një profesor për lëndën:** Kontabiliteti Menaxherial.
3. **Një profesor për lëndën:** Raportimi Financiar II .
4. **Një profesor për lëndën:** Sociologji (z).
5. **Një profesor për lëndën:** Gjuha Turke II (z).
6. **Një profesor për lëndën:** Sistemi Informativ në Biznese.
7. **Një profesor për lëndën:** Anglishtja Afariste II (z).
8. **Një profesor për lëndën:** Shkrimi Akademik (z).
9. **Një profesor për lëndën:** Bazat e Kontabilitetit II.
10. **Një profesor për lëndën:** Financat Ndërkombëtare.
11. **Një profesor për lëndën:** Gjuha Gjermane I (z).
12. **Një profesor për lëndën:** Gjuha Gjermane II (z).
13. **Një profesor për lëndën:** Ligji i Kompanive .
14. **Një profesor për lëndën:** Gjuha Turke III .
15. **Një profesor për lëndën:** Kontabiliteti Menaxherial i Avancuar.
16. **Një profesor për lëndën:** Kontabiliteti Publik.
17. **Një asistent për lëndën:** Kërkimet në Marketing.
18. **Një asistent për lëndën:** Menaxhimi i Ndryshimeve.
19. **Një asistent për lëndën:** Kontabiliteti Menaxherial.
20. **Një asistent për lëndën:** Raportimi Financiar II.
21. **Një asistent për lëndën:** Sociologji (z).
22. **Një asistent për lëndën:** Gjuhë Turke II (z).
23. **Një asistent për lëndën:** Sistemi Informativ në Biznes.
24. **Një asistent për lëndën:** Anglishtja Afariste II (z).
25. **Një asistent për lëndën:** Shkrimi Akademik (z).
26. **Një asistent për lëndën:** Gjuhë Gjermane II (z).
27. **Një asistent për lëndën:** Ligji i Kompanive.
28. **Një asistent për lëndën:** Gjuha Turke III .
29. **Një asistent për lëndën:** Financat Ndërkombëtare.
30. **Një asistent për lëndën:** Komunikimi i Tregut.
31. **Një asistent për lëndën:** Analiza Financiare.

II) FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

a) Në gjuhën shqipe:

1. **Dy mësimdhënës për lëndët**: Matematika diskrete (SD Sem II O, TIT Sem II O, MSC Sem II Z).
2. **Një mësimdhënës për lëndët:** Teknologjia e gjuhëve (MSc, Sem II Z), Algoritmet e përzgjedhura (MSc, Sem II O).
3. **Një mësimdhënës për lëndët:** Ndërveprimi njeri kompjuter (TIT Sem IV Z), Intereaksioni njeri kompjuter (SD Sem II Z).
4. **Një mësimdhënës për lëndët:** Grafikë kompjuterike dhe procesimi i imazheve (SD Sem IV O), Mikrokontrolleret (TIT Sem IV O).
5. **Një mësimdhënës për lëndën:** Konceptet e telekomunikimit mobil (TIT Sem VI O).
6. **Dy mësimdhënës për lëndët:** Anglisht për shkenca kompjuterike II (TIT Sem II Z dhe DS Sem II Z), Anglisht për shkenca kompjuterike 4 (TIT Sem IV Z).
7. **Një asistent për lëndët:** Autentifikim dhe kriptografi (TIT Sem IV O), Kompjutimi Mobil (SD Sem VI O).
8. **Një asistent për lëndën:** Algoritme dhe struktura e te dhënave (TIT Sem II O).
9. **Një asistent për lëndën:** Struktura e te dhënave dhe algoritme (SD Sem II O).

b) Në gjuhën turke:

1. **Një mësimdhënës për lëndët**: Matematika Diskrete (Sem II O).
2. **Një mësimdhënës për lëndët**: Metodat e hulumtimit (Sem VI O).
3. **Një mësimdhënës për lëndët**: Algoritme dhe strukturat e të dhënave, Teknologjia TCP/IP, Cloud Computing, Përmbajtja dinamike e ueb inxhinjeringut (Sem II O, Sem i IV O, Sem VI O, Sem VI O).
4. **Një mësimdhënës për lëndët**: Senzorët dhe interfejsi, Mikrokontrollerët, Arkitektura e sistemeve dhe sistemet operative, Autentifikim dhe kriptografi (Sem II O, Sem IV O, Sem IV O, Sem IV O).
5. **Një mësimdhënës për lëndën**:Konceptet e telekomunikimit mobil (Sem IV O)
6. **Një mësimdhënës për lëndët**: Anglisht për shkenca kompjuterike II (Sem II Z), Anglisht për shkenca kompjuterike 4 (Sem IV Z).
7. **Një mësimdhënës për lëndën**: Metodat e hulumtimit (Sem VI O).
8. **Një mësimdhënës për lëndën**: E-biznesi (Sem II Z);Ndërveprimi njeri kompjuter(TIT Sem IV Z).
9. **Tre asistent**: Për grup lëndësh.

C) Në gjuhën boshnjake:

1. **Një mësimdhënës për lëndën:** Matematika Diskrete (Sem II O).
2. **Një mësimdhënës për lëndët**: Senzoret dhe interfejsi, Mikrokontrolleret (Sem II O, Sem IV O).
3. **Një mësimdhënës për lëndët**: Algoritme dhe strukturat e të dhënave, Autentifikim dhe kriptografi, Cloud Computing (Sem II O, Sem i IV O, Sem VI O).
4. **Një mësimdhënës për lëndët**: Teknologjia TCP/IP, Ueb dizajn, Përmbajtja dinamike e ueb inxhinjeringut (Sem IV O, Sem IV O, Sem VI O).
5. **Një mësimdhënës për lëndët:** Arkitektura e sistemeve dhe sistemet operative, Hyrja ne Ueb teknologjitë dhe gjuhet, Konceptet e telekomunikimit mobil (Sem II O, Sem IV O, Sem VI O).
6. **Një mësimdhënës për lëndët**: Anglisht për shkenca kompjuterike II (Sem II Z), Anglisht për shkenca kompjuterike 4 (Sem IV Z).
7. **Një mësimdhënës për lëndët:** Metodat e hulumtimit (Sem VI O).
8. **Një mësimdhënës për lëndët**: E-Biznesi (Sem IV Z); Ndërveprimi njeri kompjuter (TIT Sem IV Z).
9. **Katër asistent**: Për grup lëndësh.

III) FAKULTETI I JURIDIKUT

1. **Dy mësimdhënës për lëndën:** Fillet e se Drejtës (Hyrja ne filozofin e se Drejtës dhe të drejtës publike), ligjërata 6 orë (O) (Një normë e plotë ose dy gjysmë normë).
2. **Dy asistent për lëndën**: E drejta Romake, ushtrime 10 orë (O).
3. **Një mësimdhënës për lëndën**: Gjuhe Angleze, ligjërata 2 orë (O).
4. **Një asistent për lëndën:** Gjuhe Angleze, ushtrime ,2 orë (Z).
5. **Një mësimdhënës për lëndën:** Gjuhe Gjermane, ligjërata 2+1 orë (Z).
6. **Një mësimdhënës për lëndën:** Teori dhe Praktike Parlamentare, ligjërata 2 orë (Z).
7. **Një asistent për lëndën**: Teori dhe Praktike Parlamentare, E Drejta Ndërtimorë dhe Planifikim Hapësinor, ushtrime 2 orë (Z).
8. **Një mësimdhënës për lëndën**: E Drejta Doganore, ligjërata 2 orë (Z).
9. **Një asistent për lëndën:** E Drejta Civile - pjesa e posaçëme (E Drejta Sendore), usht. 8 orë (O).
10. **Një mësimdhënës për lëndën:** E Drejta Administrative ligjërata 3 orë (O).

11. **Mësimdhënës për lëndën:** E Drejta Penale II, ligjërata 6 orë (O).
12. **Një asistent për lëndën:** E Drejta Penale II, Ushtrime 8 orë (O).
13. **Një mësimdhënës për lëndën:** Etika profesionale dhe ligjorë; ligjërata 2 orë (Z).
14. **Një asistent për lëndën:** Etika profesionale dhe ligjore, Penologji, ushtrime 2 orë.
15. **Një mësimdhënës për lëndën:** Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, ligj. 2 orë.
16. **Një asistent për lëndën:** E drejta Europiane, ushtrime 8 orë.
17. **Një mësimdhënës për lëndën**: E Drejta e Procedurës Civile II Jo kontestimore ligj. 6 orë.
18. **Një asistent për lëndën**: E Drejta e Procedurës Penale II, Ushtrime 8 orë.
19. **Një asistent për lëndën:** E Drejta Familjare dhe Trashëgimore, ushtrime 8 orë.
20. **Një mësimdhënës për lëndën**: E Drejta Ndërkombëtare e Punës, ligjerata 2 orë.
21. **Një mësimdhënës për lëndën;** Politikat dhe Administrata Publike, ligjërata 2 orë.
22. **Një asistent për lëndën;** Politikat dhe Administrata Publike; E Drejta Ndërkombëtare e Punës, ushtrime 2 orë.
23. **Një mësimdhënës për lëndën**: E Drejta e Procedurës administrative, ligjërata 3 orë.
24. **Një asistent për lëndën:** E Drejta e Procedurës administrative, ushtrime 6 orë.
25. **Një mësimdhënës për lëndën**: E Drejta e Ndërmarrjeve, ligjërata 3 orë.
26. **Një asistent për lëndët**: E Drejta e Ndërmarrjeve, E Drejta Doganore, Ushtrime 7 orë.
27. **Një asistent për lëndët**: E Drejta e Organizatave Ndërkombëtare, E Drejta Ndërkombëtare Humanitare; Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, usht. 4orë.
28. **Një mësimdhënës për lëndën:** Informatika dhe Krimet kompjuterike, 3 ligjërata orë.
29. **Një asistent për lëndën**: Informatika dhe Krimet kompjuterike, ushtrime 4 orë.
30. **Një mësimdhënës për lëndën**: E Drejta Ndërkombëtare Humanitare, ligjërata 2 orë.
31. **Një asistent për lëndën**: Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese; E Drejta e Medieve, ushtrime 2 orë.
32. **Një mësimdhënës për lëndën**: E Drejta e Medieve ligjërata 2 orë.

Master "Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike

33. **Një asistent për lëndën**: Kontrolli dhe auditimi në qeverisjen lokale 2 orë.
34. **Një asistent për lëndën:** Menaxhimi i burimeve njerëzore 2 orë.
35. **Një asistent për lëndën:** Sherbimet publike dhe zhvillimi ekonomik lokal 2 orë.
36. **Një asistent për lëndën:** Prokurimi dhe Transparenca 2 orë.

IV) FAKULTETI I EDUKIMIT

a) Në gjuhën mësimore shqipe:

1. **Një mësmdhënës për lendët**: Pedagogjike (Obligative dhe Zgjedhore).
2. **Nje mësimdhënës për lëndë:** Gjuha shqipe II per programin parashkollor (2 grupe) (O).
3. **Një mësimdhënës për lëndët:** Psikologjike (O dhe Z).
4. **Nje mësimdhënës për lëndët:** Metodologji e arteve figurative (O), Punë dore me medolim (O), Vizatim (Z).
5. **Një mësimdhënës për lëndët**: Strategjit dhe metodat e shkrim leximit (O) Metodologji e leximit letrar (Z).
6. **Nje mësimdhënës për lëndën**: Edukimi Mjedisor (O).
7. **Një mësimdhës për lëndën**: Bazat e shkencave natyrore me metodologji (O).
8. **Një mësidhënës për lëndët:** Metodologjia e mësimit të matematikës I (O), Metodologjia e njohjës së koncepteve matematikore (O).
9. **Një mësimdhës për lëndën**: Histori kombëtare (O).
10. **Një mësimdhës për lëndën**: Letërsi për fëmijë (O).
11. **Një asistent** për gupë lëndësh nga Pedagogjia (O dhe Z).
12. **Një asistent** për grupë lëndësh nga Psikologjia (O dhe Z).
13. **Një asistent** për lëndët, Metodologji e arteve figurative (O), Punë dore me modelim(O) Vizatim (Z).
14. **Një asistent për lëndët**: Edukimi mjedisor, Bazat e shkencave natyrore me metodologji O.
15. **Dy asistent** për lëndën, Matematika II (O).
16. **Një asistent** për lëndën, TIK per programin parashkollor dhe fillor (O).

b) Në gjuhën mësimore turke:

1. **Dy mësimdhënës** për lëndët pedagogjike (O dhe Z).
2. **Një mësimdhënës për lëndën**: Punë dore me modellim (O).
3. **Një mësimdhënës për lëndët**: Gjuhe angleze – II (Z).
4. **Dy mësimdhënës për lëndët**: Psikologjike (O dhe Z).
5. **Një mësimdhënës për lëndët**: Bazat e shkencave natyrore e metodologji (O).
6. **Një mësimdhënës për lëndët**: Artet figurative me metodologji (O).
7. **Një mësimdhënës për lëndët**: Bazat e shkencave shoqërore me metodologji (O).
8. **Një mësimdhënës për lëndët**: Historia kombetare (O).
9. **Një mësimdhënës për lëndët**: Konceptet matematikore me metodologji (O).
10. Një mësimdhënës për lëndët: Edukimi muzikor me metodologji (O).
11. **Një mësimdhënës për lëndët**: TIK per (fillor dhe parafillor) (O).
12. **Një mësimdhënës për lëndët**: Edukimi mjedisor (fillor dhe parafillor) (O).

C) Në gjuhën mësimore boshnjake:

1. **Tre mësimdhënës për lendet:** Gjuhë boshnjake II për programin fillor dhe parashkollor (O), Strategjitë dhe metodat e shkrim leximit (O), Letërsi për fëmijë (O), Komunikimi ne arsim (Z), Lojerat gjuhësore në të mësuarit e gjuhës amatare (Z), Metodika e letersisë (Z), Dramatizimi dhe shfaqjet me kukulla (Z).
2. **Dy mësimdhënës për lëndët:** Matematika II për programin fillor dhe parashkollor (O), Metodika e mësimit te matematikes I (O), Metodologji e njohjes së koncepteve matematikore (O).
3. **Një mësimdhënës për lëndët:** Filozofia e edukimit (program fillor dhe parashkollor) (O), Punë dore me modelim (O), Zhvillimi i kurrikulave (Z), Puna me fëmijë të talentuar (Z), Edukatë estetike (Z), Historia e arsimit kombëtar (Z), Arsimimi gjatë gjithë jetës (Z).
4. **Një mësimdhënës për lëndët:** TIK në edukimin fillor (O), TIK në edukimin parashkollor (O), Mediat digjitale (Z).
5. **Një mësimdhënës për lëndët:** Bazat e shkencave shoqërore me metodologji (O), Të drejtat e fëmijëve dhe etika e mësimdhënësve (Z).
6. **Një mësimdhënës për lendet:** Historia kombëtare (O).
7. **Një mësimdhënës për lendet:** Metodologji e arteve figurative (O), Artet e bukura (Z).
8. **Një mësimdhënës për lendet**: Lojrat ritmike dhe vallëzimi (Z).
9. **Dy mësimdhënës për lendet:** Praktika pedagogjike II (5 javë) PF (O) Praktika pedagogjike II (5 javë) PP (O).
10. **Një mësimdhënës për lendet**: Gjuhë angleze II (Z), Gjuhë angleze për mësues (Z).

V) FAKULTETI I FILOLOGJISË

a) Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe:

1. **Një mësimdhënës për lëndën**: Gjuhë angleze 2 dhe 4.
2. **Një mësimdhënës për lëndën**: Letërsi antike.
3. **Një mësimdhënës për lëndën**: Psikologji.
4. **Një asistent** për lëndët e gramatikës.
5. **Tre asistent** për grup lëndësh nga letërsia.
6. **Një asistent** për lëndët e gjuhës angleze 2 dhe 4.

b) Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze:

1. **Një mësimdhënës për lëndët**: Sintaksa dhe Përkthimi anglisht-shqip.
2. **Një mësimdhënës për lëndën**: Të kuptuarit e dramës.
3. **Një mësimdhënës për lëndët**: TEFL: Lexim dhe shkrim dhe Vlerësimi dhe testet.
4. **Një mësimdhënës për lëndën**: Gjuhë e huaj II.
5. **Një asistent për**: Shkathtësitë e integruara II dhe Anglishte për qëllime të veçanta.
6. **Një asistent për lëndën**: Gjuhë shqipe II.
7. **Një asistent për lëndën:** Gjuhë e huaj II.
8. **Një asistent për lëndët**: Shkrim akademik dhe Hyrje në hulumtimin shkencor.
9. **Një asistent për lëndën**: Të kuptuarit e dramës.

c) Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane:

1. **Një mësimdhënës për lëndët**: Hyrje në letërsi gjermane; Letërsi gjermane I,II, III, IV, Seminari në shkencën e letërsisë.
2. **Një mësimdhënës për lëndët**: Sintaksë e gjuhës gjermane dhe Hyrje në didaktikën e gjuhëve të huaja.
3. **Një mësimdhënës për lëndën**: Civilizim dhe kulturë gjermane II dhe komunikimi ndërkulturore.
4. **Tre asistentë për lëndët**: Praktikë e gjuhës së sotme gjermane II,IV, VI, VII, VIII.
5. **Një asistent** për letërsi gjermane.
6. **Një asistent** për lëndën e Gjuhë angleze 2 .

VI) FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT

1. **Një mësimdhënës për lëndën:** Gjuhë Angleze.
2. **Një mësimdhënës për lëndën:** Gjuhë Angleze II.
3. **Një mësimdhënës për lëndën:** Kimia e Përgjithshme dhe Organike 2.
4. **Një mësimdhënës për lëndën:** Prodhim Shtazor.
5. **Një mësimdhënës për lëndët:** Silvikultura 2 dhe Mbrojtja e Pyjeve nga Zjarret.
6. **Një mësimdhënës për lëndën:** Patologjia e Pyjeve.
7. **Një mësimdhënës për lëndët:** Bazat e Ekonomisë dhe Bazat e Marketingut.
8. **Një mësimdhënës për lëndën:** Ekonomia Bujqësore.
9. **Një mësimdhënës për lëndë zgjedhore në programin e Shkencave të Pyjeve[1].**
10. **Dy asistent për lëndë nga lëmia e Shkencave të Pyjeve.**

